



المؤسسة الإسلامية للشباب

**Fondazioni i Rinisë Islame**  
**Stiftung der Islamischen Jugend**  
**Foundation of Islamic Youth**

---

Seebacherstrasse 67  
CH-8052 Zürich  
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

[www.islamischen.ch](http://www.islamischen.ch)  
✉ [Islamischen@freesurf.ch](mailto:Islamischen@freesurf.ch)  
[info@islamischen.ch](mailto:info@islamischen.ch)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

# PËR PJEKJE PËR TA KUPTUAR BIOGRAFINË E MUHAMEDI A.S.

Mustafa Mahmud

Botuar nga: botues privat

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Gazmend Hoxha

PARATHËNIE .....	5
HYRJE .....	7
MANIPULIME ME BIOGRAFINË E LAJMËTARIT TË ZOTIT .....	7
PROFETËSI E ARGUMENTUAR .....	10
PERSONALITET UNIK .....	16
NDIHMJA NGA ZOTI - MBËSHTETJA E VETME .....	20
PROFETËSI, E JO MADHËSHTI .....	28
NJERI I RËNDOMTË, I DALLUAR ME PROFETËSI .....	28
SHEMBULLI MË I MIRË .....	30
ITHTARËT SAKRIFIKOJNË VETEN PËR TË .....	37
SHPIRTI QË NDRIÇON DHE PUSHTON .....	43
MARTESA ME KUNDËRSHTAREN LULËZOI NË DASHURI TË PAPËRSËRITUR .....	43
MËSHIRË NDAJ KRIJESAVE .....	56
EKSPEDITA E PAFRENUESHME .....	58

CILËSITË E THIRRJES SË TIJ .....	58
DURIMI I MUNDIMEVE - NË DOBI TË THIRRJES .....	61
LAJME TË MIRA PËR ISLAMIN .....	67
MARRËVESHJA NË HUDEJBIJE.....	71
THYERJA E MARRËVESHJES.....	77
HYRJA MADHËSHTORE NË MEKKË.....	79
MUHAMMEDI □ -FISNIKËRUES I NJERËZVE.....	80
PAMJA DHE VETITË SHPIRTËRORE .....	80
A THUA AI SHKROI KUR’ANIN? .....	89
SHTETI I RI .....	92
CASTET E FUNDIT TË JETËS NË KËTË BOTË.....	93
REAGIMET E MUSLIMANËVE .....	96

## PARATHËNIE

Lavd-falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botërave.

Qoftë bekimi mbi të dërguarin e Tij, Muhammedin, mbi ne dhe mbi të gjithë robërit dhe adhuruesit e All-llahut.

Në mesin e veprave më të njohura të dr. Mustafa Mahmudit gjendet edhe kjo, tanimë prezente edhe në gjuhën tonë. Edhe pse në shikim të parë duket se është një ndër veprat (e shumta) biografike mbi jetën e Lajmëtarit të fundit të Zotit, Muhammedit ﷺ, megjithatë nuk është ashtu. Kjo vepër bën fjalë mbi atë se si duhet të kuptohet biografia e tij.

Mustafa Mahmud është i njohur për spjegime të çështjeve Islamike nga aspekti shkencor, me ç'rast mosbesimtarëve u shtie dyshim në “fenë” e tyre. Në veprat e tija “Dialog me mikun ateist”, “Prej dyshimit në besim”, “All-llahu”, “Përpyetje bashkëkohore për ta kuptuar Kur’anin” dhe në këtë që keni në duar, ky autor përpiqet ta ruajë karakterin hyjnor të Islamit, e njëkohësisht t’ia bëjë të afërt Islamit intelektualëve perëndimorë, duke përdorur fakte bashkëkohore. Mu për këtë shkak, librat e tij kanë përmbajtje e cila kërkon dijeni relativisht të pasur për t’u kuptuar, pasi që autori përmend mjaft të dhëna shkencore, duke pasur për qëllim shtjellimin sa më të mirë të çështjes së parashtruar. Sidoqoftë, në veprat e tija gjendet një ngrohtësi e hijesuar nga rezultati

përfundimtar i këtyre të dhënave, të cilën shpresoj se do ta ndjeni edhe ju gjatë leximit të këtij libri.

Ja se si e spjegon ai thelbin e Islamit:

“...Specifiteti i Islamit është që të mos e shohë të mirën ideale në jetën nëpër teqe dhe manastire, e as në format e thjeshta të realitetit, por në pastrimin e realitetit aq sa ai mund të pastrohet, si dhe me vënien e një ure mes njeriut dhe jetës ideale, me qëllim që njeriu të ngrehet në shkallën e jetës ideale hap pas hapi, duke mos e ngarkuar natyrën e tij të paqëndrueshme. Të mos ishte kjo butësi në bartjen e detyrave dhe ky ushtrim gradual i shpirtit, ideali do të ngelej në yjësinë e vet si ngjyra në letër, ndërsa njeriu do të humbej nën thundrat e materies ashtu siç humbet uji në rërë...”

(nga faqja 83<sup>2</sup> në këtë libër)

Ju dëshirojmë lexim të këndshëm...

“Thuaj (Muhammed):

O njerëz, unë jam për të gjithë ju i dërguar nga

All-llahu, të Cilit i takon sundimi i qiejve dhe i tokës. S’ka hyjni tjetër pos Tij, Dhënësit të jetës dhe Dhënësit të vdekjes. Pra, besoni All-llahun dhe të dërguarin e Tij, Lajmëtarin që nuk di shkrim-lexim, i cili beson All-llahun dhe Fjalët e Tij. Pasojeni atë, që të jeni në rrugën e drejtë!”

(Kur’an: A’RAF 158)

## HYRJE

# MANIPULIME ME BIOGRAFINË E LAJMËTARIT TË ZOTIT

Në kohë të fundit, ndër të tjerat po paraqitet edhe një formë e re e biografisë së Muhammedit ﷺ. Autorët e saj përpiqen që t'ia zhveshin Muhammedit ﷺ çdo gjë që është mbinatyrore dhe e papranueshme për mendjen njerëzore. Ata na e prezantojnë Muhammedin ﷺ përmes të qëndruarit e tij në shpellën Hira duke theksuar se është tërhjekur në vetmi, e nuk na spjegojnë edhe mënyrën e veçantë të të folurit të tij me All-llahun ﷻ<sup>ii</sup>, por e përshkruajnë në këtë mënyrë:

“...(Tërhiqet në shpellën Hira) që ta studjojë gjendjen e proletariatit Kurejsh<sup>iii</sup> dhe për të gjetur mënyrën e shpëtimit të tij nga shtypja e zotërinjve Kurejshë, në dritën e ligjeve të reja...”

Këta autorë prej Lajmëtarit të madh bëjnë diçka që i ngjan Çegevarës, ndërsa nga Islami diçka që i përngjan një revolucioni shoqëror, duke i dhënë krejt kësaj një karakter të paramenduar dhe kuptim sipas dëshirës. Duke studjuar kështu jetën e Muhammedit ﷺ, autorët mendojnë se janë shërbyer me metodë shkencore, madje edhe se i kanë shërbyer fesë me atë që e kanë larguar Muhammedin ﷺ nga ndodhitë me Xhibrilin, me shpalljen e Kur'anit nga ana e All-llahut ﷻ, dhe me udhëtimin e Israsë<sup>iv</sup>.

Autorët e këtij lloji të biografisë mendojnë se me këtë e kanë rritur respektin ndaj të Dërguarit ﷺ, se kanë filluar të flasin në gjuhën bashkëkohore dhe se kanë filluar të flasin në gjuhën e atyre që nuk besojnë. Në të vërtetë ata nuk e kanë bërë këtë, por u janë mikluar (pabesimtarëve) duke shpërndarë ndodhi arbitrare, rrena dhe falsifikime, ndërsa të Dërguarin ﷺ e kanë zbritur në nivel

të liderit lokal dhe në nivelin e politikanit të thjeshtë duke ia zhveshur atij cilësinë e të Zgjedhurit të All-llahut ﷻ dhe atij që bart amanetin e All-llahut ﷻ.

Në këtë qëndrim këta autorë marrin për argument edhe ajetet nga Kur'ani në të cilat All-llahu ﷻ i drejtohet Muhammedit ﷺ, dhe këtë e bëjnë sipas sistemit të “citateve të cingëra”, si p.sh.:

“Thuaj: Unë jam njeri si edhe ju...”

duke e lënë pa treguar pjesën më kryesore të porosisë, të përmbajtur në këtë ajet:

“Thuaj: Unë jam njeri si edhe ju, (por) mua më shpallet se Zoti juaj është Një Zot: kushdo që pret takimin me Zotin e vet le të punojë vepra të mira, dhe në adhurim ndaj Zotit le të mos përziejë askë!”<sup>v</sup>

Pikërisht edhe kjo përmbushje e ajetit të cituar mohon të kuptuarit biografik të jetës së të Dërguarit ﷺ. I Dërguari ﷺ është njeri i veçantë, shembull për ne, ndërsa ne nuk jemi si ai... Atij i është dorëzuar Shpallja, ndërsa neve jo...

Ky ndryshim delikat është përmbajtur në fshehtësinë e profetësisë<sup>vi</sup>. I Dërguari ﷺ është shembulli më i mirë për ne, ai është njeri si ne, por ne përsëri nuk jemi si ai.

Muhammedi ﷺ në prezencën e melekëve dhe Zotit të botërave sheh me sytë e tij Xhibrilin dhe e dëgjon atë, ndërsa as shokët më të ngushtë të tij (as'habët) nuk kanë fat që t'ua zbulojnë këtë kënaqësi ndijesave të tyre, ose madje edhe të marrin pjesë në këto relacione madhështore.

Kjo, për ne - njerëzit e thjeshtë është një gjendje transcendentale<sup>vii</sup>, një hapësirë ndërmjet të arritshmes dhe të paarritshmes. Duke ndenjur në bregun e asaj që mund të shihet dhe të ndihet,

përpiqemi të shohim qoftë edhe për një moment bregun tjetër. Ky është dallimi ndërmjet evlujave<sup>viii</sup> dhe reformatorëve shoqërorë nga njëra anë, dhe të Dërguarve nga ana tjetër.

Lajmëtarit ﷺ i janë dhënë çelësat për çdo gjë. Ai i pranon dhe na i përcjell fjalët madhështore, ligjet, përcaktimet dhe detyrat nga Zoti i tij... Sipas kësaj detyre jashtzakonisht të ndershme, të lartë dhe e cila kërkon përgjegjësi, ai është i ruajtur nga mëkatet dhe nuk e thotë atë që i shkon ndërmend<sup>ix</sup>.

Nga ana tjetër, reformatori shoqëror është luftëtar. Qëndrimi i tij është edhe i yni, ndërsa pjesëmarrja e tij - pjesëmarrje e jonë. Ai gabon dhe ia qëllon, dhe nuk mundet të lirohet nga prangat e ndijesave.

Çfarë dallimesh të mëdha paska në pozitat e këtyre burrave - gati se në proporcionet e sferave qiellore! Çfarë nënçmimi do të ishte për të gjithë të Dërguarit nëse ne do t'i zhveshnim nga kjo shkallë e lartë hyjnore! Çka do të ngelte nga besimi nëse ne do ta mohonim atë që është e pakapshme për trurin njerëzor?

Interpretimin që na e ofrojnë autorët e këtij lloji të biografisë së Muhammedit ﷺ është një përpjekje e qartë për përgënjeshttrimin e të paarritshmes për trurin njerëzor.

Sipas të gjitha gjasave këta autorë shërbehen me metoda që kanë përmbajtje të dyshimtë shkencore!

## PROFETËSI E ARGUMENTUAR

A nuk i përshkruan All-llahu ﷻ besimtarët me këtë ajet:

“Ata që i besojnë të fshehtës...”<sup>x</sup>

dhe sipas kësaj, Ai e kushtëzon imanin (kulminacionin e besimit) me besim në të fshehtën (gajb):

“...Ndërsa ai që nuk beson Zotin, engjujt e Tij, librat (e shpallura) të Tij, ka humbur tepër larg.”<sup>xi</sup>

Besimi në engjëjt është kusht i theksuar për besimin në vetë Zotin. Përsëri, qasja “bashkëkohore” ndaj problemeve në këtë shekull është duke hyrë qetë në çdo trajtim të çeshtjeve, madje edhe në të kuptuarit tonë të profetësisë. Për këtë shkak shkrimtari bashkëkohor mendon se do të kishte qenë më mendjeprehtë dhe më i kthjellët në shkrimet e tija nëse do të fliste për Muhammedin ﷺ ashtu siç është shkruar për Abraham Linkolnin. Kjo do të ishte një introduktë<sup>xii</sup> më “shkencore” rreth kësaj çështjeje. Megjithatë, kjo nuk është as shkencore e as objektive, sepse çdo i dërguar është edhe reformator, ndërsa reformatori nuk është edhe i dërguar, pa dallim se sa i madh ka qenë suksesi i reformave të tija.

Esenca e profetësisë nuk është reformë. Esenca e saj është diçka abstrakte dhe përgjithmonë e padeshifruar. Kjo është një gjendje transcendentale, një hapësirë ndërmjet natyrës dhe metafizikës<sup>xiii</sup>. Kjo gjendje e bën të dërguarin perceptues të një lloji special, i cili pranon inspirimet nga sferat e larta, të paperceptueshme për të tjerët. Për këtë shkak lajmëtari ka nevojë për të ashtuquajturën përgatitje shpirtërore, e cila në përgjithësi dallohet nga parapërgatitja intelektuale që i është e nevojshme reformatorit shoqëror.

Përgatitjet që i bën reformatori shoqëror mbështeten në studim, përvojë, konsultim me burimet shkencore si dhe në literaturën e nevojshme. Përgatitjet e të dërguarit dallohen plotësisht nga këto përgatitje. I dërguari nuk ka nevojë për studimin e burimeve shkencore ose leximit të literaturës së posaçme, “esenciale” për profesionin e tij, por ka nevojë për zemër të pastër, zemër pa probleme dhe preokupime; pastaj ai duhet të ketë kujdes që vëmendja e tij të mos jetë e tërhequr nga problemet e panevojshme, të çlirohet nga prangat e dëshirës dhe pasionit, dhe ta koncentrojë të gjithë vëmendjen e tij në të kërkuarit e të Vërtetës Absolute - All-llahun ﷻ.

Për këtë shkak Ibrahim i ﷺ doli dhe vëzhgoi hënën dhe yjet, Isai ﷺ doli në shkretirë, Musai ﷺ agjëroi dyzet ditë për t’u takuar me Zotin, ndërsa Muhammedi ﷺ u tërhoq në shpellë.

Ai nuk vetmohej në shpellë për ta studjuar gjendjen e vështirë të “proletariatit” Kurejsh siç mendojnë disa. Ky mendim është tepër i tejdukshëm dhe tregon se në çfarë shkalle të ulët kanë arritur ata që përpiqen ta ndryshojnë qasjen bashkëkohore ndaj kësaj çështjeje. Në nivelin e atëherëshëm të zhvillimit të Kurejshët nuk kishte ndonjë lloj industrie me anë të së cilës do të mundësohej zhvillimi i proletariatit, por ekzistonte skllavëria. Kohë pas kohe do të shpërthente ndonjë konflikt mes fiseve dhe si pasojë e kësaj, zotëriu do të shndërrohej në rob, ndërsa robi në zotëri. Kjo shpesh bëhej edhe befasisht dhe pa ndonjë parapërgatitje të gjatë. Fituesi do ta shndërronte të fituarin në rob sipas ligjit “i forti fiton të dobëtin”. Kështu vazhdonte derisa do të ndërrohej situata përsëri, në kushte të reja.

Kur Muhammedi ﷺ erdhi në këtë botë, në shoqërinë Kurejshe ekzistonte robëria. Ai edhe kur e la këtë botë, në shoqërinë Kurejshe ngeli robëria. Edhe Muhammedi ﷺ gjatë jetës së vet kishte robër lufte, që do të thotë se ai gjatë izolimit të tij në shpellën Hira nuk paska qenë i preokupuar

me problemin e zotërinjve dhe robërve. Preokupimi i tij i vetëm ishte njohja e Zotit si i Vetëm, i Pashoq. Lëvizja Islame nuk ishte luftë klasore ose ndërrim klasor, por evolucion intelektual, moral dhe kulturor. Thelbi i kësaj lufte qëndronte në shkatërrimin e totemizmit dhe vendosjen e idesë monoteiste; në shkatërrimin e idesë të adhurimit të idhujve kah ideja e adhurimit të Zotit të Vetëm. Për këtë shkak, Muhammedi ﷺ përpiqej që pas shpalljes së Islamit ta vendosë çdonjërin në pozitën të cilës i takonte: çdo shembullor në pozitë të lartë dhe të ndershme tek populli i tij, përveç nëse ky do të refuzonte shkatërrimin e idhujve. Në këtë rast Muhammedi ﷺ do ta ndërronte nga pozita.

Roli shoqëror i Islamit u vu në pah kur shteti i ri dhe i bashkuar ndjeu nevojë për kushtetutë të re, ligje të reja dhe relacione të reja ndërnjerëzore. Atëherë u shpallën edhe fragmentet e Kur'anit në lidhje me të drejtën sociale dhe në lidhje me shpërndarjen e pasurisë, për çka flitet më gjërësisht në libra tjera, të cilat i spjegojnë këto çështje. Megjithatë, njeriu përsëri mund të pyetet:

“A thua vallë Muhammedi ﷺ nuk ka mundur të jetë ndonjë gjenij, ose ndonjë lider dhe politikan, për të cilin historia akoma nuk ka dëgjuar? Përse në këtë njeri të mos shihet një reformator i llojit të vetëm?”

Si ta bindim intelektin e pastër shkencor për thelbin e këtij revelacioni (profetësie), duke ditur se pyetja e Xhibrilit dhe e shpalljes së Kur'anit nga qiejt i takon vetëm Muhammedit ﷺ, ndërsa për këtë nuk kemi kurfarë argumenti mbinatyror, por duhet vetëm t'i dorëzohemi pa asnjë polemikë, ndërsa një gjë të tillë shkenca nuk mundet ta pranojë! Mundet ata, të cilët i parashtrojnë këto pyetje pohojnë duke shtuar:

“Edhe ne e kuptojmë si edhe ti se qëllimi i paraqitjes së Muhammedit ﷺ nuk ishte ndërrimi klasor ose problemi mes robërve dhe zotërinjve. Qëllimi i paraqitjes së tij ishte persiatja mbi të Vërtetën dhe të Mbinatyreshmen - All-llahun ﷻ. Nga ana tjetër, a nuk ishte ky qëllim edhe i të gjithë filozofëve që nga Sokrati e gjer te Platoni, prej Aristotelit gjer te Kanti, Hegeli etj...? Përse ti nuk e paraqet atë si një nga këta filozofë, duke e ditur se disa nga këta kanë qenë edhe analfabetë, si shembull, Sokrati? Përse thua se Muhammedi (ﷺ) është i dërguar dhe kaq insiston në këtë? A mos ke ndonjë argument përveç imanit (besimit), me të cilin do të na kishe bindur me arsye, që të besojmë edhe ne dërgimin e tij nga ana e Zotit?”

Këto janë pyetje të arsyeshme, të cilat na tërheqin me tërësinë e tyre kah shenjat e jashtme të profetësisë të Muhammedit ﷺ. Kjo çështje më ka preokupuar qëmoti, kur akoma i lexoja biografitë e Muhammedit ﷺ dhe mendoja mbi jetën e njeriut që ndërroi botën, ndërsa vetë jetoi dhe vdiq si njeri i thjeshtë dhe modest. Unë nuk do të flas mbi mrekullitë, për të cilat flasin biografët e jetës së këtij njeriu të madh. Islami nuk u largohet mrekullive për ta kënaqur botën. Muhammedi ﷺ çdokujt që do ta luste që t'i tregojë ndonjë çudi do t'i përgjigjej:

“Unë jam vetëm ai që tërheq vëmendjen, e jo prodhues çudirash.”

Halid ibn Velidi, i cili ishte kalorës Kurejsh dhe vrasës në kohën paraislamike, duke e pranuar Islamin tha:

-Tanimë i është bërë e qartë çdo njeriu të mençur se Muhammedi nuk është magjisttar ose poet dhe se fjala e tij është njëkohësisht fjalë e Zotit të botërave. Çdo njeri i mençur duhet ta pasojë.

Ebu Sufjani u hidhërua nga fjala e Halidit dhe tha me mllef:

-Pasha Latin dhe Uzanë<sup>xiv</sup>, po ta dija se e thua të vërtetën do të të kisha vrarë ty o Halid, para se do ta kisha vrarë Muhammedin!

Halidi ia ktheu:

-Pasha Zotin, Muhammedi e thotë të vërtetën, edhe pse ti e kundërshton këtë!

Ebu Sufjani u hodh që ta vrasë, por e pengoi Ikrima ibn Ebu Xhehl, i cili ishte prezent.

-Mos shpejto, Ebu Sufjan! - tha Ikrima - Ju dëshironi ta vritni Halidin për shkak të mendimit të tij! Pasha Zotin, frikësohem se situata do të ndërrohet tërësisht, dhe se të gjithë banorët e Mekkes do të fillojnë ta pasojnë Muhammedin!

Pra, kjo ishte luftë mendimesh, ndërsa argumentet e Islamit janë gjithmonë arsyeja dhe logjika, e jo mrekullitë dhe çudirat. Edhe Ikrima, një ndër pabesimtarët dhe kundërshtarët më të mëdhenj, babai i të cilit ishte i vrarë nga ana e muslimanëve në luftën e Bedrit, thotë i frikësuar:

“Pasha Zotin, frikësohem se situata do të ndërrohet tërësisht, dhe se të gjithë banorët e Mekkes do të fillojnë ta pasojnë Muhammedin!”

Shihet se ai ka qenë i frikësuar nga argumenti i qartë, i cili po pranohej anembanë, ndërsa nuk frikohej se Muhammedi ﷺ do të krijojë ndonjë dukuri mbinatyrore, ose diçka që nuk i takon fuqisë njerëzore.

Në rastin e Muhammedit ﷺ mrekullia nuk manifestohet në shndërrimin e shkopit në gjarpër ose ndarjen e detit në dy pjesë (sikur te Musai ﷺ), e as në ngjalljen e të vdekurve ose shërimin e të

zgjebosurve (sikur te Isai ﷺ), por në paraqitjen mbinatyrore të personalitetit të Muhammedit ﷺ, i cili përmbloodhi në vete përsosuri të shumta dhe në çdo përsosuri arriti kulminacionin.

Muhammedi ﷺ ishte person i jashtëzakonshëm, i cili dallohej qoftë në sjellje, qoftë në mënyrën e jetesës.

Nëse personaliteti yt arrin përsosurinë në ndonjë cilësi dhe me këtë cilësi i tejkalon shokët e tu të njëjtët profesion, atëherë kjo është gjenialitet:

Nëse arrin kulminacionin e oratorisë, bëhesh Demosten; nëse arrin kulminacionin në poezi, bëhesh Bajron; nëse arrin kulminacionin në udhëheqje bëhesh Berkli; nëse arrin kulminacionin në urtësi bëhesh Lukman, nëse arrin kulminacionin në aftësitë luftarake, bëhesh Napoleon; nëse arrin kulminacionin në ligjdhënie, bëhesh Solon.

Por, të jesh njëkohësisht si të gjithë këta, duke të sprovuar koha, e megjithatë ta arrish qëllimin përfundimtar, pa shkollë dhe pa mësues, atëherë kjo do të jetë me të vërtet një dukuri mbinatyrore... Dhe nëse kjo vërtet do të ndodhë, atëherë mënyra e vetme e sqarimit është se këtu bëhet fjalë për profetësi, përkrahje dhe ndihmë nga vetë All-llahu ﷻ, Bëmirësi. Ky pra është argumenti im mbi profetësinë e Muhammedit ﷺ.

## PERSONALITET UNIK

Ja pra, gjendemi para njeriut i cili kur ligjëron, të duket si retoriku më i madh, ndërsa kur thotë diçka, mënyra e të folurit të tij tingëllon rrjedhëshëm, ëmbël dhe qartë. Ai nuk flet nga dëshira ose mllëfi, por nga urtësia e të Urtit<sup>xv</sup> dhe vizioni i inspiruar nga Ai, i cili sheh çdo gjë... Tërësia e këtyre dukurive të lidhura me personalitetin e Muhammedit ﷺ na tregojnë se janë nga gjithësia, larg asaj që është e zakonshme për natyrën njerëzore.

Këtë orator të qetë, kur shkon në betejë e shohim si luftëtar të pashoq dhe të jashtëzakonshëm, si dhe strateg të llojit të veçantë. Ky është ai luftëtar, i cili kur shpërndau ushtarët në betejën e Uhudit, vendosi pesëdhjetë shigjetarë në kalimin te gryka, të cilët do të shërbenin si mbrojtës të ushtrisë, duke u thënë:

“Na mbron!... ruani pozitat e juaja dhe mos i lëshoni... Edhe nëse vëreni se jemi duke hyrë në logorin e armiqëve dhe se i shkatërojmë forcat e armiqëve, ju mos e lëshoni pozitën tuaj! Por edhe nëse hetoni se na sulmojnë, na fitojnë dhe se na vrasin, mos ejani në ndihmë! Detyra juaj e vetme është që t’i qëlloni kuajt e tyre me shigjeta, sepse kuajt nuk përparojnë në kahjen prej nga sulmohen me shigjeta!”

Është i njohur fakti se muslimanët e humbën këtë betejë pikërisht për shkak të mosrespektimit të këtij urdhëri të Lajmëtarit ﷺ nga ana e shigjetarëve të lartpërmendur, për shkak se ata i lëshuan pozitat e tyre në momentin kur hetuan se armiku filloi të zbrapset, e këtë e bënë për shkak të dëshirës ndaj presë së luftës. Atëherë Halid ibn Velidi, komandanti i atëherëshëm i ushtrisë

Kurejshe<sup>xvi</sup> sulmoi ushtrinë muslimane pas shpine. Kështu fitorja e muslimanëve u shndërrua në humbje.

Çka ndërmori Muhammedi ﷺ si udhëheqës ushtarak në atë moment?

Tani shohim një pamje tjetër: pamjen e trimërisë, guximit, largpamësisë dhe rrezikut të llogaritur me precizitet. Nuk kaluan as njëzet e katër orë, ndërsa atë e shohim si i mbledh ushtarët e plagosur dhe të rraskapitur për ta ndjekur ushtrinë fitimtare gjer në Mekë... Kur e dikton këtë, Ebu Sufjani - komandanti suprem i ushtrisë kundërshtare, frikësohet shumë. Ky mendoi se Muhammedi ﷺ ka sjellur ushtarë të freskët nga Medina. Ebu Sufjani u thërret ushtarëve të tij se Muhammedi ﷺ është nisur me një grup ithtarësh, të cilët nuk i kishte parë askush më parë:

“Muhammedi po ju arrin! Me të janë edhe ata që kishin ngelur pas! Të gjithë së bashku kërkojnë hakmarrjen më të rreptë!...”

Ushtria e të plagosurve arriti gjer te vendi i quajtur Hamra’ul-Esed dhe ndezi zjarre tri netë me rradhë duke pasur për qëllim që armiku të mendojë se ata janë riorganizuar dhe përgatitur për një sulm vdekjeprurës. Ebu Sufjani u thye nga frika. Shpejt u tërhoq me ushtrinë në Mekë duke u frikësuar se mos po e humbë fitoren e lehtë në Uhud.

Kështu armata e thyer pati sukses ta kthejë besimin dhe lavdinë, që pas betejës së Uhudit u sollën në pozitë të palakmueshme. Rëndësinë e kësaj trimërie mund ta kuptojë plotësisht vetëm luftëtari me përvojë të gjatë. Ky aksion guximtar dhe njëkohësisht i rrezikshëm na zbulon një shkathtësi, e cila nuk mund të realizohet nga njeriu i thjeshtë.

Diçka më vonë në një betejë tjetër, kur çështja u bë tejet e vështirë, në një situatë eksplozive e shohim këtë strateg genial si kalon prej prapavijës në rreshtat e parë luftarakë.

Shigjetat, shpatat dhe shtizat vringëllojnë rreth tij. Vdekja korr njerëz nga çdo anë, ndërsa Muhammedi ﷺ palëkundëshëm përparon me shpatën e tij...

Ishte kjo në betejën e Hunejnit, kur armiku vërshoi ushtrinë muslimane herët në mëngjez me shigjeta nga kodra e afërt, duke bërë kështu kaos ndër rreshtat e ushtarëve muslimanë. Muslimanët filluan të mendojnë për ikje. Kjo i dha kurajo Ebu Sufjanit që të thërrasë me ironi:

“Nuk do t’u kryhet dështimi para detit<sup>xviii</sup>!”, ndërsa Shejb ibn Uthman thërriti duke sharë:

“Sot hakmarrja ime do ta arrijë Muhammedin!”

Çfarë bëri Muhammedi ﷺ kur pa dymbëdhjetë mijë ushtarë muslimanë të shkatërruar dhe disfatën e luftës njëzetvjeçare sa çelë e mshelë sytë? Duke nxitur mushkën e tij filloi të përpiqet që të lëvizë ndërmjet turmës, e cila vërshonte si lumë. I gozhdoi këmbët në tokë derisa mijëra ushtarë armiq lëshoheshin mbi shpatin e kodrës dhe ndiqnin muslimanët duke i hedhur në tokë nga ana e djathtë dhe e majtë e Profetit të tyre. Qëndroi mbi turmën e ushtarëve që ikin në panikë...

Ibn Harithi filloi me gjithë fuqinë t’u bërtasë muslimanëve:

“Ensarë<sup>xviii</sup>, muhaxhirë<sup>xix</sup>, o ju që u përbetuat!... Muhammedi është i gjallë!... Këndej!”

Muhammedi ﷺ qëndroi si shkëmb mbi këtë zjarr luftarak dhe filloi të thërrasë:

“Ku shkoni njerëz! Unë jam i dërguar, jo rrenacak!... Qëndroni!”

Janë këto momente trishtuese... Momente kur ndërrohet ardhmëria...

Zemrat e ushtarëve hetuan se sa trimërisht po qëndronte i Dërguari ﷺ, udhëheqësi i tyre, i cili shihte vdekjen me sy. Ushtarët që pak më parë iknin, filluan të thërrasin nga të gjitha anët:

“Të përgjigjemi... Të përgjigjemi, o i dërguar i All-llahut!” duke i kthyer dizgjet e kuajve nga kahja e ikjes në kahje të rreshtave të parë luftarakë.

Historianët na përcjellin se dy fise muslimane qenë të shfarosur këtë ditë gjer te i fundit. Pas kësaj, dështimi kaloi në fitore absolute. Muslimanët fituan në këtë betejë njëzet e dy mijë deve, dyzet mijë dele, katër mijë okë argjend dhe gjashtë mijë robër lufte, të cilët i shpien gjer te vendi Xha’ran.

Që të kuptohet se me çfarë armiku (të fortë) luftuan muslimanët atë ditë, mjafton të citohet dialogu ndërmjet një ushtari musliman dhe kundërshtarit të tij:

“...Muslimani nxorri shpatën dhe iu turr armikut, por shpata nuk i prente. Kundërshtari ironikisht i tha:

-Të paska armatosur keq nëna! Merre shpatën nga samari im dhe më prej me të! Ngreje mbi bërryl dhe lëshoje nën ball! Unë kështu i prisja kokat me të. Ndërsa kur do të shkosh te nëna, thuaji se e ke vvarë Durejd ibn es-Samiun... Pasha Zotin, do të ngelësh ti pa gratë e tua!...”

Një ushtar i tillë vlente sa dhjetë të tjerë. Ushtria muslimane nuk luftonte kundër hijeve, por kundër trimave të vërtetë. As i Dërguari ﷺ nuk e fshihte admirimin e tij ndaj komandantit kundërshtar Malik ibn Aufit...

## **NDIHMA NGA ZOTI - MBËSHTETJA E VETME**

...Kur u shkatërrua ushtria kundërshtare, komandanti i saj Malik ibn Aufi iku me disa ushtarë të vetë në fortesën Taif. I Dërguari ﷺ e lajmëroi me anë të një anëtari të familjes së tij se do t'ia lirojë të gjithë anëtarët e familjes së gjerë, se do t'ia kthejë tërë pasurinë e zaptuar gjatë luftës dhe se do t'ia japë edhe njëqind deve, vetëm nëse kthehet si musliman. Kur Maliku dëgjoi këtë premtim, në fshehtësi lëshoi fortesën dhe erdhi gjer te i Dërguari ﷺ. Pranoi Islamin publikisht, mori familjen dhe pasurinë, si dhe njëqind devet e premtuara.

Ky veprim na ilustron sjelljen e një njeriu, qëllimi i të cilit nuk është robërimi ose preja e luftës, por pastrimi i zemrave të njerëzve, të cilat më vonë do të shndrisin, e me këtë do të krijohet harmonia në këtë botë. Nga ky veprim gjithashtu shohim udhëheqësin e madh, cili di të vlerësojë vlefshmërinë e njerëzve, qofshin ata edhe armiq të tij.

Së fundi, si qe trajtimi i Muhammedit ﷺ ndaj presë së luftës, për të cilën muslimanët bënë gara se kush do të fitojë më tepër?

Qëndroi pranë deves së tij i hidhëruar, shkuli një qime nga shpina e saj dhe e vendosi ndërmjet gishtave, e ngriti lartë dhe tha:

“Njerëz! Pasha Zotin, mua më takon nga preja e luftës vetëm e pesta. Ajo pjesë nuk është e juaja. Ma dorëzoni mua të pestën! Njerëz, pasha Zotin, edhe nëse do të kisha aq deve sa ka trungje në Tuhamë<sup>xx</sup> do t’ua kisha shpërndarë të gjitha. Së fundi, ju nuk më njihni si dorështrenguar, frikacak ose rrenacak!”

Më vonë Muhammedi ﷺ ua dorëzoi edhe pjesën e vet shokëve të tij të mëparëshëm. Nga njëqind deve u dha:

Ebu Sufjanit dhe birit të tij, Muadhrit;

El Harith ibn Keldit;

El Harith ibn Hishamit;

Suhejl ibn Amrit;

Huvejtib ibn Abdul-uzait, si dhe udhëheqësve të tjerë shembullorë, ndërsa nga pesëdhjetë deve u dha edhe personave tjerë, të cilët më pak meritonin prenë e luftës. Kjo i shtyu Ensarët që të pëshpërisin:

“...Do t’ia shpërndajë mallin popullit të vet (Mekasve)...”

Kur Muhammedi ﷺ i dëgjoi këto pëshpëritje pas shpine, i thirri të gjithë Ensarët për t’ju drejtuar atyre me këto fjalë prekëse:

“Ensarë, ç’është kjo që po dëgjoj për ju? A nuk ju erdha kur ju endeshit, ndërsa All-llahu ju udhëzoi, ishit të vobekët, ndërsa All-llahu ju pasuroi, ishit armiq të njëri-tjetrit, ndërsa All-llahu ju miqësoi?”

“Për Zotin, po e thotë të vërtetën!” -thanë ensarët.

“A nuk do të më përgjigjeni, ensarë?” -i pyeti i Dërguari ﷺ.

“Në çka të të përgjigjemi, o i Dërguar i Zotit?”

“Për Zotin, po të donit, do ta thonit, do ta vërtetonit e me këtë edhe do të vërtetoheshit<sup>xxi</sup>: Na erdhe kur përpiqeshin të të demantojnë, e ne të vërtetuam, na erdhe i braktisur, e ne të ndihmuam, ishe i dëbuar, e ne të dhamë strehim, ishe i vobekët, e ne të përkrahëm... O ensarë, ju e konsideroni të vlefshme atë që është e parëndësishme në këtë botë, por me anë të së cilës mund t’i përfitoni njerëzit për ta pranuar Islamin. O ensarë, a nuk ju vjen mirë kur shihni se njerëzit tjerë kujdesen për delet dhe devet, ndërsa ju ktheheni me të Dërguarin tuaj në rresht...? Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti i Muhammedit, të mos ishte hixhra, edhe unë do të isha një ndër ensarët, dhe nëse populli do të shkonte në një udhë, ndërsa ensarët në udhë tjetër, do të kisha shkuar në udhën e ensarëve. O Zot, mëshiroji ensarët, fëmijët e tyre dhe fëmijët e fëmijëve të tyre!”

Këto mendime i Dërguari ﷺ i tha tepër i tronditur.

Ensarët filluan të qajnë dhe thanë:

“Jemi të kënaqur me ndarjen dhe pjesën që na e caktove!”

Atëherë u shpallën edhe këto ajete vijues nga Kur’ani, të cilët e përshkruajtën këtë betejë, e cila u shndërrua prej dëshimit në fitore, duke zbuluar edhe disa fshehtësi:

“All-llahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, si dhe atë ditë në Hunejn, kur ju pat habitur numri i madh i tyre (armiqëve), por ajo atyre nuk u solli kurrfarë dobie, dhe sadoqë toka është e gjerë, ajo juve ju ngushtua, prandaj ju ikët;

Pastaj All-llahu lëshoi qetësinë e vet mbi të Dërguarin dhe mbi besimtarët e vet dhe ju dërgoi një ushtri, të cilën ju nuk e patë dhe dënoi ata që nuk besuan. Ai ishte shpërblimi për pabesimtarët.”<sup>xxii</sup>

Ajo fuqi e cila përforcoi të Dërguarin ﷺ dhe besimtarët ishte ndihma e Zotit. Ai ua pat dërguar ushtrinë, të cilën asnjëra nga dy palët nuk e kishin vërejtur.

Cilët janë ata ushtarë?

Kjo është ajo e paarritshmja për trurin njerëzor. Kthesat e shpejta dhe të papritura të kësaj beteje trishtuese asnjëherë nuk do të arrijnë ta bindin mendjen njerëzore, përveç nëse supozohet se muslimanët kanë pasur ndihmë nga ajo që nuk mundet të paramendohet ose sqarohet.

Të njëjtin shembull e kemi edhe në betejën te Bedri, kur treqind muslimanë u ballafaquan me njëmijë pabesimtarë, me ç’rast muslimanët nuk kishin ndonjë përgatitje të madhe: ata posedonin vetëm tre kalorës, derisa pabesimtarët Kurejsh kishin përgatitje deri te mburojat e hekurta, duke pasur me vete më se njëqind kalorës.

Muhammedi ﷺ filloi ta lusë Zotin e tij me shuplaka të shtrira lart qiellit:

“Zoti im, këta janë Kurejshët, të cilët sollën kalorësinë e tyre, po përpiqen ta përgënjeshtrojnë të dërguarin Tënd...

Zoti im, të lutem më ndihmo me atë që më premtove...

Zoti im, nëse sot shkatërrohet ky grup, Ti nuk do të jesh më i adhuruar...”

Muhammedi ﷺ me shumë përlësi dhe me gjithë zemër iu lut Zotit të vet derisa nuk i ra mbështjellësi.

A mund t'i shkojë ndërmend dikujt se ky grup i vogël me armët e tyre primitive do ta mundë këtë grup të madh me mburoja të hekurta, pa mbështetje në diçka që është për trurin njerëzor e paarritshme?

Kur’ani tregon për disa fshehtësi të kësaj beteje:

“All-llahu ju ka ndihmuar edhe në Bedër, kur ishit të pafuqishëm, prandaj frikësojuni All-llahut që të jeni mirënjohës!

Kur u pate thënë besimtarëve: A nuk ju mjafton ajo që Zoti juaj po ju dërgon në ndihmë tre mijë engjuj?

Po, si jo! Nëse jeni të qëndrueshëm dhe të devotshëm, dhe nëse ata ju sulmojnë menjëherë, Zoti juaj do t’ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjuj, të gjithë të shenjuar.

Këtë All-llahu e bëri që t’ju gëzojë dhe me këtë t’jua qetësojë zemrat, por fitorja vjen vetëm nga All-llahu, i Forti dhe i Urti.”<sup>xxiii</sup>

Edhe në një vend tjetër në Kur’an flitet për të njëjtën ndodhi:

“Kur Zoti yt u shpalli engjujve: Unë jam me ju, andaj inkurajoni ata që besojnë! Unë do t’i mbush me frikë zemrat e pabesimtarëve, andaj ju mëshoni kresë dhe gishtërinjve!”<sup>xxiv</sup>

“Ata nuk i keni mbytur ju, por i ka mbytur All-llahu, dhe kur gjuaje, nuk gjuaje ti, por gjuante All-llahu, për t’i sprovuar besimtarët me një sprovë të mirë nga ana e Tij. All-llahu njëmend dëgjon dhe i di të gjitha.”<sup>xxv</sup>

Këto janë disa fshehtësi të paqarta për trurin njerëzor, fshehtësi të përkrahjes së Zotit ndaj njeriut, kur ai i drejtohet me sineritet dhe përlulje, madje edhe kur forcat materiale nuk janë të barabarta. Në atë moment vjen përkrahja e fshehtë nga shtegu i panjohur, të cilin syri njerëzor nuk mund ta hetojë, e as veshi ta dëgjojë, dhe kështu realizohet drejtësia origjinale e Zotit.

Ky është Muhammedi ﷺ, i zgjedhuri i Zotit; njeriu i cili arriti kulminacionin e përsosurisë njerëzore. Ai është njeriu i devotshëm që sinerisht dhe me përlulje lut All-llahun, por njëkohësisht edhe luftëtar i vërtetë, që i ekspozohet rrezikut vdekjeprurës, i fortë dhe i qëndrueshëm derisa mijëra kalorës dhe trima ikin pranë tij të frikësuar. Ai është strategu luftarak, plánet e të cilit i tejkaluan plánet që i bënëin dhe akoma i bëjnë njerëzit më të mëdhenj të të njëjtit profesion. Politikani më i shkathët, që vë në lëvizje grupe të tëra, duke i udhëhequr kështu ndjenjat e tyre me mjeshtrinë e një mjeshtri të madh.

Muhammedi ﷺ është prind, burrë dhe shok, mirëpo atij i është dhënë profetësia. Ai vë rendin dhe formon shtetin prej asgjëje: prej fiseve dhe grupeve të shpërndara, të cilat kanë të ngjashme vetëm plaçkitjen, vrasjen, hakmarrjen dhe mburrjen familjare. Ai është penda transcendentale e fshehtësive, të cilat na e zbulojnë mbretërinë hyjnore, njeri i cili dëgjon All-llahun dhe engjëjt ashtu siç dëgjojmë ne njëri - tjetrin, duke e arritur kështu kulminacionin e njohjeve ezoterike dhe egzoterike në të njëjtën kohë...

Ai është fisnik, i dashur, i këndshëm, mallëngjyes, i mëshirëshëm, i durueshëm, i kthjelltë, i buzëqeshur, i shoqërueshëm...

Atij nuk i pengon fëmija që luan mbi shpinën e tij, kur është duke u falur. Detyra e rëndësishme që i është dorëzuar - profetësia nuk e pengon as në zbatimje me gruan e vet, duke i kushtuar asaj kujdes, ngrohtësi dhe ndjenja.

Ndjenjat e tij janë të pashterrshme. Të duket se burojnë nga deti.

Një personalitet i tillë është vetvetiu dukuri e jashtzakonshme. Ekzistimi i të gjitha këtyre përsosmërive në një person është vërtet dukuri mbinatyrore. Kjo nuk mund të jetë gjenialitet. Gjenialiteti është dukuri, kur një person i tejkalon të tjerët vetëm në një drejtim. Nga ana tjetër, nëse një person përmban në vete një varg të përsosurive, atëherë nuk ka dyshim se bëhet fjalë për profetësi. Diçka e tillë mund të realizohet vetëm me ndihmën e Zotit, mbrojtjen e Tij, si dhe me përforcimin dhe dhurimin e begative nga ana e Atij të cilit i takon thesari i mirësive të panumërta.

Ky është argumentimi im për profetësinë e Muhammedit ﷺ. Gjendemi pranë një personi absolutisht unikat, i cili në vete i ka përmbledhur të gjitha atributet e përsosmërisë. Ai sikur po-

sedon një fuqi magjike ndaj atyre që janë rreth tij, ashtuqë me çdonjërin që vë kontakt, e shndërron në hero. Në histori ky njeri është personifikim i trimërisë katërmëdhjetë shekullore dhe si i tillë do të mbetet edhe në të ardhmen - për të gjitha kohërat.

Sipas kësaj, gjendemi pranë Muhammedit ﷺ - profet, e jo ndonjë njeriu që i ngjan Linkollnit ose Çegevarës, siç mendojnë disa që udhëzojnë në shkencë, pa pasur baza të shëndosha shkencore.

Nuk jemi pranë ndonjë reformatori shoqëror ose pranë revolucionit Spartan. Assesi! Krahasimet e tilla janë tepër qesharake. Nga ana tjetër, rekomanduesit e mendimeve të tilla i bënë padrejtësi të Vërtetës dhe të Dërguarit ﷺ, nuk e vlerësuan mirë dhe as që e vështruan unitetin e rolit të tij. Gjendemi para një personi, me anë të të cilit udhëzohemi nga Krijuesi i tij dhe i jonë, i dërguar si mëshirë ndaj të gjitha botërave, të cilin e lavdëron dhe e bekon edhe vetë Krijuesi i tij (në Kur'an):

“Dhe nuk të dërguam ty (për tjetër gjë), pos si mëshirë ndaj botërave...”<sup>xxvi</sup>

“Vërtet All-llahu dhe engjëjt e Tij e bekojnë Lajmëtarin. O ju që keni besuar, bekojeni atë dhe përshëndeteni (me salam) duke iu nënshtruar!”<sup>xxvii</sup>

Le të jetë pra, o Muhammed bekimi, paqja dhe mëshira e Zotit mbi ty përgjithmonë! Ti vërtet je mëshira e Zotit ndaj nesh.

## PROFETËSI, E JO MADHËSHTI NJERI I RËNDOMTË, I DALLUAR ME PROFETËSI

Në vazhdim të shfletimit të biografisë së Muhammedit ﷺ lexuesi do të ketë rast ta vërtetojë se nuk ka nevojë për ikje nga argumentimi i dukurisë mbinatyrore, sepse gjendemi para njeriut i cili është shumë më tepër se një njeri i madh.

Ky analfabet nomad dhe i thjeshtë ecë në mesin e njerëzve pa kryelartësi, flet si edhe të tjerët, nuk mbahet i ditur, nuk lexon libra, e as nuk studjon drejtimit filozofike, nuk shërbehet me asgjë që që do të ishte shkak i përfitimit të pozitës dhe madhësisë në këtë botë, nuk ka tituj akademik, e as trashëgim të natyrës materiale.

E paramendoj se në çfarë humnere do të kishim rënë kur do ta kishim përzier personalitetin e Muhammedit ﷺ me personalitetet e mendimtarëve të mëdhenj, gjenive dhe dijetarëve, si dhe me personalitetet e diplomatëve dhe politikanëve, të cilët kanë gjithmonë para sysh një qëllim të caktuar. Nga ana tjetër, kemi të bëjmë me një person që plotësisht dallohet. Është nga urtësia dhe providenca e Zotit që zgjodhi një natyrë të tillë beduine për t'ia dorëzuar Fjalët e Tija - Kur'anin, që të mos dyshohet në vërtetësinë e tyre.

Gjatë pranimit të shpalljes nga engjëlli Xhibril ndërrohet plotësisht gjendja e brendëshme e tij. Të duket se takimi me ato fjalë është një ndeshje e tmerrshme prej të cilës nuk ka ikje. Kur vijnë këto fjalë të Zotit, e përfshin një hutesë - ballin e tij e kaplojnë djersët, ndërsa trupi i tij rëndohet, ashtuqë nëse është duke kaluar, edhe devja gjunjëzohet dhe garritë nga pesha e madhe. Kur do

t'i ndërpritej shpallja, do të vinte në vete pa e humbur fuqinë, dhe do t'ua përcillte njerëzve shpalljen.

Pra, kjo nuk është epilepsi<sup>xxviii</sup> të cilën ia përshkruajnë disa orientalistë qëllimqë sa për t'ia zvogëluar vlerën profetësisë së tij. Epilepsia e shter fuqinë nga trupi dhe në përgjithësi fshin kujtesën gjatë momenteve të përjetimit të sulmit. Trupi është në gjendje të plogësht dhe të alivanosur, dhe i sëmuri bie në gjumë të thellë ose në ndonjë lloj zgjimi, në të cilin përzihen realiteti me ëndrrën. Kjo është qëmoti e njohur në shkencën medicinale. Falimentim i tërësishëm. Kur sulmi ndërpritet, i sëmuri nuk është në gjendje të bëjë asgjë për një kohë të gjatë. Gati sa nuk i këputet peri i jetës nga pamundësia dhe humbja e kontrolit ndaj të gjithë asaj që e punon dhe që e flet.

Një gjendje e tillë asnjëherë nuk është hasur te Muhammedi ﷺ, i cili ishte shembull respekti, zgjuarsie, mendjeprehtësie, përsosmërie trupore, pa asnjë sëmundje, i aftë shpirtërisht dhe fizikisht të durojë peshë dyfish më të madhe se atë që do të kishte mundur ta durojë njeriu mesatar. Kur bëhet fjalë për atë, duket se bashkësi e tërë është përmbledhur në një njeri.

Ky është një shembull i vërtetë i forcës dhe shkathhtësisë, ndërsa ajo që manifestohet te epileptiku është shprehje e dobësisë dhe lodhjes. A thua paska këtu ndonjë ngjashmëri?

Kur vëzhgojmë personalitetin e Muhammedit ﷺ në veprat biografike, do të vërejmë se me veprimin e tij të paluhatshëm ndikon në mënyrë magjike ndaj këtij rrethi beduin. Kurdo që prek njeriun, e shndërron atë në dritë që hecë, zgjon në të dëshirën për mirësi dhe frymëzon derdhjen e lumenjve të dashurisë prej tij...

## SHEMBULLI MË I MIRË

Të shohim se si ishte gjendja e ‘Umer ibn Hatabit ﷺ<sup>xxix</sup> para pranimit të Islamit, i cili qe njeri i ashpër dhe gjithnjë i mllefosur, i fundosur në alkohol dhe dëfrim të pakufizuar, e si u ndërrua pas asaj prekjeje magjike...

Ndodhi kjo në kohën kur filloi torturimi i muslimanëve të parë nga ana e zotërinjve Kurejsh. Padroni i Bilalit<sup>xxx</sup> ﷺ e hodhi atë mbi rërën e zjarrtë, duke i vënë një shkëmb mbi gjoks, vetëm pse e kishte pranuar Islamin. Edhe pse po i përjetonte mundimet më të mëdha, Bilali nuk lëshonte tjetër zë pos:

“Një (Zot), Një... Një!”

I duronte mundimet për hir të besimit ndaj Zotit të Vetëm...

Për fat të tij, rastësisht atypari kaloi Ebu Bekri ﷺ, i cili kur e pa të munduarin vendosi që ta blejë nga padroni i tij dhe pastaj e liroi atë. Ebu Bekri ﷺ bleu edhe disa të tjerë që t'i shpëtojë nga mundimet e rënda. Ndër ta ishte edhe robëresha e ‘Umer ibn Hatabit ﷺ, e cila ishte prej atyre që kishin gjendjen më të rëndë. Asaj ia kishin lidhur muskujt për kuajsh dhe ia kishin shkepur krahët, vetëm për shkak se kishte kundërshtuar urdhërin e padronit për ta braktisur Islamin dhe për t'iu kthyer fesë së vjetër (politeiste). Kështu ajo vdiq nga humbja e madhe e gjakut.

Edhe pse muslimanët tjerë nuk ishin robër, ata u rrahën dhe u përndoqën.

Në ndërkohë Ebu Lehebi, një prej kundërshtarëve më të mëdhenj ia hodhi të Dërguarit ﷺ organet e brendëshme të deles së therrur mbi shpinë derisa ai falej, ndërsa gruaja e tij hodhi

plehëra pranë derës së të Dërguarit, dhe në rrugën kah kalonte hodhi therra. Ebu Lehebi nuk u kënaq vetëm me këtë, ai gjithashtu i urdhëroi fëmijët ta gjuajnë me gurë, ndërsa poetët ta përqeshin...

Muslimanët iu ankuan Muhammedit ﷺ për mundimet që po i përjetonin. Ai i këshilloi që të shpërndahen dhe të kërkonjë strehim në Abisininë (Etiopinë) krishtere:

“Në të gjendet sunduesi që nuk mundon askë. Ai është shteti i së vërtetës. Shkoni që t’ju japë All-llahu shpëtimin nga gjendja në të cilën jeni!”

Ata u tërhoqën pa u vërejtur, duke marrë me vete vetëm gjërat më të nevojshme. Njëmbëdhjetë meshkuj dhe katër gra dolën fshehurazi nga Mekka natën, para agimit...

‘Umer ibn Hatabi gufoi nga mllefi dhe hidhërimi nga ky njeri<sup>xxxii</sup> që i përçau dhe i fyu arabët; ëndërrat e tyre i quajti marrina, ndërsa zotërat e tyre i ofendoi dhe i përqeshi... Kur dëgjoji se Muhammedi ﷺ është takuar me shokët e tij Hamzën, Ebu Bekrin dhe Aliun në një shtëpi, shpejt mori shpatën dhe doli jashtë, i vendosur për ta vrasë. Sipas tij, me vrasjen e Muhammedit ﷺ do të përfundonte përçarja e arabëve dhe ata do të mund ta rikthenin “unitetin” e tyre. Rrugës e takuan dy njerëz, të cilët kur e diktuan qëllimin e tij, i thanë:

“Umer, për Zotin je duke shpejtuar! A mendon se Abdimenafët<sup>xxxiii</sup> do të lejojnë ta vrasësh Muhammedin, e pastaj të të lënë të gjallë mbi tokë? Kthehu së pari te familja yte dhe përmirësoje gjendjen!”

Atëherë ‘Umerit iu kujtua e motra Fatimja dhe burri i saj ibn Zejdi, të cilët e kishin pranuar Islamin. Shpejt u kthye dhe hyri fuqishëm në shtëpinë e së motrës ku vëreu leximin e Kur’anit. Fatimja fshehu fletën në të cilën qe i shkruar teksti nga Kur’ani. Kur e pa, ‘Umeri thërriti:

“Çfarë pëshpëritje qe kjo...?”

Ata refuzuan të pranojnë, por ‘Umeri thërriti me mlllef:

“Mora vesh se edhe ju po e ndiqni Muhammedin në fenë e tij!”- dhe i ra shuplakë dhëndrit të vet. Kur Fatimja u çua ta mbrojë burrin e saj, ‘Umeri i ra edhe saj aq fortë, saqë i plasi gjaku. Atëherë të dy i thanë:

“Po, pranuan Islamin, bë ç’të duash!”

‘Umeri u shqetësua shumë, e nga ana tjetër vëreu rrjedhjen e gjakut nga fytyra e së motrës. Në ato momente shpirti i revoltuar i Umerit u mallëngjye dhe filloi ta kaptojë një dhimsuri për ta. Ia kërkoi të motrës fletën ku qe i shkruar teksti. Filloi t’i lexojë fjalët që ndriçuan mendjen e tij:

“Ta. Ha.

Ne nuk ta shpallëm Kur’anin për të të munduar,

por vetëm si këshillë për ata që frikësohen.

Shpallje nga Ai që krijoi tokën dhe qiejt e lartë,

Mëshiruesi që qëndron mbi Arsh

E tija është ç’kanë qiejt dhe ç’ka toka, dhe ajo ndërmjet tyre, si dhe ajo nën dhé...”<sup>xxxxiii</sup>

Këto fjalë ndikuan shumë në ndërrimin e qëndrimit të tij ndaj Islamit. Shkoi deri te shtëpia ku gjendej Muhammedi ﷺ me shokët e tij, kërkoi falje dhe publikisht pranoi Islamin. Se ç'ndodhi më vonë me Umerin ؓ të cilin bukur mirë e njeh historia, nuk ka nevojë të sqarohet.

Kjo është ajo prekje magjike e cila “çan detin, e cila shndërron shkopin në gjarpër, shëron të verbërit, dhe e cila ngjall të vdekurit”.

Ndodhia te vendi Rexhi është një shembull ilustrues i dashurisë që kishin ithtarët ndaj tij. Kjo ndodhi pas humbjes së muslimanëve në betejën e Uhudit. Kur pabesimtarët e panë se mundën t'i thejnë muslimanët, u ngjall në ta urrejtja e vjetër. Një ditë te Muhammedi ﷺ erdhi një grup i vogël arabësh dhe i thanë:

“...Në familjet tona ka edhe prej tyre që dëshirojnë ta pranojnë Islamin. Le të vijmë me ne disa nga shokët e tu të cilët do të na i mësojnë ligjet e Islamit dhe leximin e Kur'anit!”

Muhammedi ﷺ dërgoi me ta gjasht as'habë të dalluar. Kur këta u larguan dhe erdhën deri te udhëheqësi i fisit Lahdil në vendin e ashtuquajtur Rexhi, arabët e njejtë i sulmuan as'habët, duke e thirrur në ndihmë edhe fisin Lahdil.

Grupi i Lahdilasve thërriti: Për Zotin, ne nuk duam t'ju vrasim, por t'ju dorëzojmë në Mekkë.”

Kjo donte të thotë fatkeqësi më të madhe se vdekja. Ata donin t'i shesin në Mekkë si robër, që Kurejshët të sillen me ta në mënyrën më të ashpër. Vdekja do të ishte më e mirë.

Muslimanët filluan të luftojnë. Tre u vranë në luftë, ndërsa të katërtin e vranë me gurë. Dy të fundit i lidhën me zinxhirë dhe i shitën si robër. Zejd ibn Desene ra në duart e Safan ibn Umejti, i cili e bleu që ta vrasë dhe kështu ta hakmarrë babain e vet, Umej ibn Halefin. Halefin e vranë muslimanët në betejën e Bedrit. Safani ia dorëzoi Zejdin robit të tij të liruar, Nastasit që ta vrasë. Kur e çuan Zejdin në vendin ku duhej të vritet, Ebu Sufjani e pyeti:

“Pash Zotin Zejd, a do të kishe dashur që tani të jetë Muhammedi në vendin tënd, e ti t’ia presh kokën dhe pastaj t’i kthehesh familjes?”

“Pasha Zotin,- tha Zejdi - nuk do të kisha dashur as therra ta shpojë atje ku është tash (në vend të sigurtë) ndërsa unë të jem me familjen time. “Nuk kam parë askë - tha Ebu Sufjani - që kaq shumë e duan shokët, ashtu siç e duan as’habët Muhammedin.”

Zejdi u vra nga Nastasi. Ai ra dëshmor i dashurisë dhe besimit, shembull për muslimanët tjerë.

Robin tjetër (Hubejben) e burgosën, dhe kur e nxorrën që ta varin, ai u tha: “Nëse mendoni të më vritni, më lëshoni së pari t’i fal dy rekate!”

I lejuan. I fali dy rekate ashtu si duhet, pastaj u kthye dhe tha: “Pasha Zotin, ta dija se nuk mendoni se po zvarritem prej frikës nga vdekja, do të isha falur edhe më...”

E ngritën në vendin ku duhej ta varin. Kur e lidhën, ai shikoi rreptë ndërsa nga sytë i shkrepse flaka dhe thërriti i hidhëruar: “O Zot, merri të gjithë! Shkatërroi të gjithë! Mos le asnjë të gjallë!”

Frika i kaploi prej bërtitjes. U rrëzuan në tokë që mos i zë mallkimi i tij dhe pastaj e varën.

Këta dy robër lufte kishin mundësi ta shpëtojnë jetën me braktisjen e Islamit. Megjithkëtë besimi dhe dashuria ndaj All-llahut, të Dërguarit dhe Islamit bënë që kjo botë të duket tepër e imët në krahasim me atë që posedonin në zemrat e tyre.

Të shohim se ç’thotë Urve ibn Mes’ud Sekafiu për këtë dashuri të pakrahasueshme...

Kur Urve u kthye nga negociatat<sup>xxxiv</sup> në Mekkë, filloi t’u tregojë njerëzve të vet për Muhammedin ﷺ dhe as’habët:

“Kurejshë, unë kam qenë te oborri i mbretit persian, i mbretit bizantin dhe i mbretit etiopian, dhe vërtet asnjëherë nuk kam parë sundues të tillë mes popullit siç është Muhammedi mes as’habëve. Kur dëshironte të marrë abdest, shpejtonin kush i pari t’i derdhë ujë, kur i binte ndonjë fije floku, ata e merrnin. Ata nuk do ta tradhtojnë asnjëherë dhe për asgjë!”

Ky shembull tregon se as’habët nuk e bënë këtë për shkak të madhësisë së Muhammedit ﷺ por për shkak të dashurisë së sinqertë që ndjenin ndaj tij.

Muhammedi ﷺ ishte i njohur për nga modestia. Shpesh u thoshte as’habëve:

“Mos u ngreni në këmbë sikur që ngrehen të panjohurit ndaj njëri tjetrit që të tregojnë madhështi dhe respekt. Mos më madhëroni siç e madhërojnë të krishterët Isain, birin e Merjemes!”

Muhammedi ﷺ madje i mësonte as’habët edhe si të ulen gjatë ngrënies, dhe u thoshte:

“Unë jam njeri dhe ulem si çdo njeri. Ushqehem siç ushqehet çdo njeri. Le të mësojë muslimani se me çfarë modestie duhet të ulet dhe si të sillet gjatë të ushqyerit, sepse ushqehet me begatitë që ia ka dhënë All-llahu.”

Gjatë takimit me Muhammedin ﷺ një beduini i dukej frikërespekti dhe tronditja nga takimi me liderin e muslimanëve. Muhammedi ﷺ tha:

“Mos u trondit! Unë jam njeri nga fisi Kurejsh, nëna e të cilit ka ngrënë bukë të thatë!”

Kjo do të thotë se Muhammedi ﷺ nuk e tregonte veten të madh, e as që i udhëzonte as’habët në këtë.

Siç na përcjellin historianët sjellja e as’habëve ndaj tij rridhte nga dashuria, rrespekti dhe besimi, si pasojë e prekjes magjike, të panjohur për trurin njerëzor dhe nga dashuria ndaj Muhammedit ﷺ të cilën Zoti e ka mbjellur në zemrat e njerëzve.

All-llahu ﷻ i thotë Musait ﷺ:

“...Nga ana Ime mbolla dashuri ndaj teje, që të edukohesh pranë syrit Tim...”<sup>xxxv</sup>

Kështu faraoni, i njëjti njeri që dha urdhër për vrasjen e të gjithë fëmijëve të gjinisë mashkullore, kur pa Musain në djep iu zbut zemra dhe urdhëroi që ta pranojnë në pallat dhe të përkujdeshen për të...

Këtu gjendet mbështetja në atë, që për trurin njerëzor është e paprekshme, mbështetja me të cilën arrihen të gjitha sukseset dhe arritjet, mbështetje të cilën All-llahu ia ka dhënë të Dërguarit ﷺ. Dashuria ndaj tij vërehet gjithkund, madje edhe në zemrat e beduinëve të vrazhdë dhe të egër, të cilët në periudhën paraislamike i varrosnin për së gjalli bijat e tyre.

Pa këtë përkrahje të Zotit nuk do të mundeshim të spjegojmë disa ndodhi të cilat na duken si imagjinata.

## ITHTARËT SAKRIFIKOJNË VETEN PËR TË

Ç'ndodhi në Mu'ëte?

Muslimanët morën urdhërin nga i Dërguari ﷺ që të nisen në Siri, për t'i dënuar fiset të cilët kanë braktisur fenë dhe të cilët kishin sulmuar grupet muslimane të dërguara nga Muhammedi ﷺ që kishin për detyrë përhapjen e Islamit (në mënyrë paqësore). Muslimanët u nisën me 3000 ushtarë. Ata i udhëhiqte Zejd ibn Harithi. Para se të niseshin i Dërguari ﷺ u tha: “Nëse Zejdi plagoset, udhëheqjen le ta ndërmerr Xhafer ibn ebi Talibi, ndërsa nëse edhe ai goditet, komandën le ta ndërmerr Abdullah ibn Revahal!”

Ushtria u nis. Asaj iu bashkangjiti Halid ibn Velidi, që të tregojë anën e tij të mirë në sprovim. Kjo njëkohsisht ishte edhe beteja e parë, prej kur e kishte pranuar Islamin. Shpejtuan dhe i sulmuan Sirianët në befasi siç e kishte traditë i Dërguari ﷺ gjatë betejave. Mirëpo, për këte ekspeditë luftarake ishte i njoftuar edhe guvernieri bizantin. Ai filloi ta mbledhë ushtrinë dhe t'i tubojë fiset. Gjithashtu kërkoi ndihmë nga Herakli, i cili e ndihmoi me një ushtri të madhe, numri i përgjithshëm i së cilës sillej rreth 100.000, të cilën e komandonte Theodori, vëllai i Heraklit.

Kur muslimanët morën vesh për numrin e madh të ushtarëve që po i dërgonte Herakli, dy ditë menduan rreth zgjidhjes së çështjes. Dikush tha: “T’i shkruajmë Muhammedit ﷺ që të na dërgojë ndihmë ose të na urdhërojë të kthehemi?” Dhe ky mendim do të aprovohej, nëse nuk do të ishte Abdullah ibn Revaha...

Abdull-llahu qe kalorës, poet i dalluar dhe orator i mirë. U çua dhe filloi të thërrasë me zë të lartë: “O Njerëz! Për Zotin, atë që ju po e përbuzni është ajo, për të cilën keni dalur ta kërkon: të bieni dëshmorë në rrugën e Zotit! Ne nuk luftojmë kundër armikut me numër, forcë ose shumicë; por luftojmë me fenë me të cilën All-llahu na ka lartësuar. Të nisemi, se prej kësaj mundemi të fitojmë një nga këto dy të mira: fitoren ose rënien shehid<sup>xxxvi</sup>!”

Përballë tij u dëgjua jehona e zërave të ushtarëve:

“Për Zotin, Revaha ka të drejtë!”

Dhe kështu vazhduan rrugën, gjersa arritën te kufiri El-Belka. Këtu u takuan me ushtrinë e Heraklit, e cila qe përbërë nga arabët dhe bizantinët. Muslimanët pushtuan fshatin Mate dhe u vendosën aty.

Filloi lufta mes 100.000 ushtarëve bizantinë nga njëra anë dhe 3000 muslimanëve nga ana tjetër. Zejd ibn Harithi e mbante flamurin e të Dërguarit ﷺ. U hodh në sulm me një trimëri të jashtzakonshme, duke i bërë ballë vdekjes së sigurtë. U mbajt në këmbë deri sa e vërsjuan shtizat e armiqëve. Flamurin e mori Xhafer ibn ebi Talib. Ishte ky një djalosh i mahnitshëm 33 vjeçar. Ky luftoi duke e mbrojtur flamurin deri sa armiku ia rrethoi kalin. Atëherë ai këceu nga kali, e therri dhe u turr ndërmjet ushtarëve armiq, të cilët bërtitnin me të madhe. Vringëllonte me

shpatën në armiqtë nga të gjitha anët. Flamurin e mbante në dorën e djathtë, ndërsa kur ia prenë atë, e mori me të majtën. Më në fund, kur ia prenë edhe dorën e majtë, flamurin e mori me nënbrrylat dhe e çoi lartë deri sa nuk vdiq. Thuhet se një bizantin i ka rënë aq fortë saqë ia ka ndarë trupin në dy pjesë. Pas vrasjes së Xhaferit flamurin e mori Ibn Revaha. Ky u nis përpara duke e trimëruar veten me vargjet:

“Po të betohem o shpirt se do të lëshoj.  
Do të lëshoj, o shpirt ose do të përbuz!  
Njerëzit thërrasin dhe ushtria po shtohet.

Çfarë po ndodh me ty, o shpirt,  
a thua ti nuk e do  
...xhennetin për mua?

Mori në dorë shpatën Revaha dhe luftoi deri sa e vranë.

Pastaj flamurin e mori Thabit ibn Erkemi dhe tha:

“O muslimanë, zgjidheni dikë që do ta ndërmarë udhëheqjen!”

“Bëhu ti!” iu përgjigjën.

“Jo, unë nuk mund ta bëj këtë!” tha ai dhe u tërhoq.

...Më vonë u dakorduan që Halid ibn Velidi ta ndërmarrë komandën luftarake.

Halidi e ndërmorri komandën, edhe pse vëreu shpërndarjen mes muslimanëve dhe dobësimin e forcës morale. Halidi qe një luftar i shkëlqyeshëm dhe ushtar i përkryer. Pa u hamendur u vërsul drejt rreshtave të armiqëve. Tregojnë ata që e kanë parë se kur u është turrur ushtarëve armiq ka bërë tollovi mes tyre si ndonjë uragan, ndërsa ata kanë ikur prej tij duke ia lëshuar rrugën nga frika. Gati asnjëherë nuk është kthyer e të mos linte kokat e armiqëve të rrëzuara anembanë. Që të përshkruhet më mirë, Halidit iu thyen nëntë shpata gjatë luftës me armiqtë, deri sa nuk mori shpatën e gjerë të Jemenit.

Ushtarët armiq u gjetën në një frikë të tmerrshme për shkak të vendosmërisë dhe trimërisë të jashtzakonshme të muslimanëve. Lufta zgjati deri sa u err. Atë natë Halidi bëri plan të ri ushtarak. Si strateg i shkathët, ai vendosi një rresht tjetër ushtarësh pas frontit të cilët do të bëjnë zhurmë të madhe kur do të agojë, ashtu që armiqtë të mendojnë se ka ardhur ndihma nga i Dërguari ﷺ.

Dhe vërtet, armiqtë e menduan këtë dhe i ndërprejnë sulmet. Ranë në dyshim se si të luftojnë tani. E panë se çfarë bënte një grusht muslimanësh, e kumë kur do të vijë përforcimi. Ata e dinin se çdo musliman është trim dhe luftëtar i pakursyeshëm.

Armiku qe tepër i gëzuar që muslimanët nuk sulmojnë. Posaçërisht u gëzua kur vëreu se ata po kthehen në Medinë. Nuk ndërmorri asgjë për ta ndaluar tërheqjen.

Ky ishte plani i Halidit për tërheqjen e 3000 luftëtarëve muslimanë nga 100.000 ushtarë armiq, edhe atë me dinjtet.

Kjo ndodhi ka edhe vazhdimin e vet, i cili befason edhe më tepër: Urve ibn Umer el-Xhezami, arab i krishter, komandant i një aradhe bizantine, ishte shumë i befasuara nga mbrojtja e ushtarëve

muslimanë. Vëreu se luftonin si luanë. Në vete përshpëriste: “Domosdo këta muslimanë kanë të drejtë. Në ta ka një forcë të çuditshme. Domosdo ajo që ua jep atë forcë është madhështore.” E pranoi Islamit dhe e shpalli këtë. Ushtarët e kapën dhe me urdhërin e Heraklit e paditën për tradhti. Megjithkëtë i ofruan që të zgjedhë: ose ta vrasin ose t’i kthehet krishterizmit. Madje i premtuan që nëse i kthehet fesë së vjetër do t’ia rikthejnë pozitën e komandantit të aradhës. Megjithatë ai i patundur zgjodhi vdekjen, dhe e vranë.

Si pasojë e kësaj ishte zgjerimi i Islamit ndërmjet fiseve që gjindeshin në kufijt e Irakut dhe Sirisë, mu aty ku qeverisja bizantine qe mjaft e fortë.

Kur u përhap lajmi për këtë, mijëra njerëz nga fisi Esxh, Gatafan, Abs, Zubjan dhe Fezar e pranuan Islamit, e më vonë mijëra banorë nga fisi Selim në krye me Abas ibn Mardasin.

Kjo çështje kërkon një sqarim. Nëse themi se as’habët e dalluar, të cilët kanë kaluar në të gjitha sprovimet, të formuara nën ndikimin direkt të Muhammedit ﷺ dhe në “shkollën” e tij, çka të themi për Urven krishter, komandantin e aradhës bizantine, si edhe për të tjerët? Nuk na mbetet asgjë tjetër, pos të përfundojmë se këta kanë qenë njerëz, mbi të cilët kanë rënë rrezet e Muhammedit ﷺ, ashtu që edhe vetë kanë filluar të ndriçojnë dhe të ndikojnë në të tjerët, e këta të ndikojnë në të tretit dhe kështu me rradhë. Si edhe të përpiqesh ta vështrosh lëvizshmërinë e këtyre ngjarjeve, përsëri nuk do të mund ta sqarosh se si Muhammedi ﷺ, një person i vetëm i cili qe i shtypur dhe i dëbuar ndikon pas së gjithash në një numër të vogël personash të cilët mund të numërohen në gishta; pastaj ai grusht i njerëzve të ndershëm dhe shembullor ndikon në disa qindra, pastaj në mijëra dhe në qindra mijëra, të cilët së bashku më vonë e shkundin Bizantin dhe Persinë, dy shtetet më të fuqishme të asaj kohe. Dhe e gjithë kjo bëhet për disa vjetë, si pasojë e

ndryshimeve rrënjësore që i shkakton Islami, i cili si ide filloi që nga zeroja, nga nomadët e thjeshtë, nga arabët e përcarë, në panumër shumë fise të përcara, të cilët nuk kishin kurrfarë civilizimi ose shkence që do të ishte e denjë për t'u përmendur. Me llogaritjet e tua nuk do të arrish asnjëherë në ato rezultate aq të mëdha. Barazimi do të jetë i paplotë dhe i pasaktë deri sa të mos e vësh në llogari edhe faktorin e fshehur, faktorin që truri i njeriut nuk mund ta arrijë, faktorin e ndihmës së Zotit, i cili mundëson suksesin.

Të shohim se ç'thotë All-llahu ﷻ në Kur'an për komandantin ngadhënjyes Dhulkarnejnin, i cili udhëtoi prej lindjes deri në perëndim:

“Vërtet ne i mundësuam atij forcë në tokë dhe i dhamë mundësi që të mund ta arrijë çdo send.”<sup>xxxvii</sup>

Logjika e arsyeshme jep përgjigjen më të saktë: pasoja rrjedh nga shkak, e ky rrjedh nga shkak para tij ndërsa shkak i parë rrjedh nga Shkaktari Fillestar, i Cili i ka çelësat e të gjitha portave. Kjo pra është fshehtësia e çdo sukcesi.

Prej kësaj, kur flasim për personalitetin e Muhammedit ﷺ, ne jemi para një profetizmi i cili është i mbështetur në forcën, që për trurin e njeriut është e fshehur. Flasim për njeriun të cilit i është ofruar ndikimi hyjnor, e jo madhështia; i cili nuk është reformator shoqëror, revolucionar ose dijetar që punon me devotshmëri duke e përdorur dijeninë e fituar më parë...

I pamë shembujt e ndikimit të këtij shpirti profetik, i cili ndriçon çdo gjë rreth tij, e pastaj kjo përcillet edhe në të tjerët...

Të shohim tani në mënyrë më intime suazat e jetës së Muhammedit ﷺ, në sjelljen e tij ndaj grave të veta, ta sqarojmë këtë ndikim ndriçues të këtij personaliteti të madh duke i dhënë edhe më tepër kthjelltësi. Ta marrim si shembull Safijen, të bijën e liderit hebraik Hajj ibn Ahtabit, i cili ishte një ndër armiqtë më të mëdhenj të Muhammedit ﷺ.

Këtu do të ndalemi edhe në luftën e Muhammedit ﷺ me armiqtë që nga fillimi i saj.

## **SHPIRTI QË NDRIÇON DHE PUSHTON MARTESA ME KUNDËRSHTAREN LULËZOI NË DASHURI TË PAPËRSËRITUR**

Kur flasim për konfliktin mes Muhammedit ﷺ dhe kundërshtarëve të tij, na duket se jemi pranë një epepeje, kapitujt e së cilës përfshijnë 20 vjet të jetës profetike. Të përpiqemi të kthehemi në histori dhe të shohim se ç'ndodhi:

Kur Ebu Bekri me butësi dhe mirësi thirri Fenhasin që ta pranojë Islamin, ai i tha me kryelartësi: “Për Zotin Ebu Bekër, ne nuk kemi nevojë për Zotin, por Ai ka nevojë për ne. Ne nuk mundemi t'i nënshtrohemi por Ai duhet të na nënshtrohet. Ai nuk na duhet. Ai nuk mund të jetojë pa ne... Sepse nëse Zoti juaj është i pasur, ai nuk do të mirrte hua nga ne, ashtu siç mendon udhëheqësi juaj, Muhammedi. Ai neve na ndalon kamatën, ndërsa vetë e merr pasurinë tonë me kamatë.

Fenhasi me këto fjalë qartë dhe në mënyrë hipokrite aludoi në ajetin Kur'anor:

“Kush është ai që ia huazon All-llahut një hua të mirë, e Ai t’ia shtojë shumëfish? All-llahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai.”<sup>xxxviii</sup>

Fenhasi me qëllim e komentoi tekstualisht këtë ajet, sepse me hua në kontekst nënkuptohet bërja e veprave të mira. Ebu Bekri e pa rreptë dhe i tha me mllef:

“Pasha Zotin, nëse nuk do të ishte në fuqi marrëveshja (paqësore) mes nesh, do ta kisha prerë kokën, o armik i Zotit!” Për këtë ofendim Ebu Bekri u ankua te i Dërguari ﷺ, megjithkëtë Fenhasi mohoi atë që kishte thënë. Me këtë rast u shpall ajeti:

“All-llahu dëgjoi fjalën e atyre që thanë: “All-llahu është i varfër, ndërsa ne jemi të pasur!” Ne do ta shënojmë atë që thanë ata dhe që i mbytën Lajmëtarët pa kurrfarë faj, e do t’ju themi: “Vuajeni mundimin e djegies së zjarrit.”<sup>xxxix</sup>

Armiqtë e të Dërguarit ﷺ bënë përpjekje që të shtinë përçarje mes dy fiseve muslimane - Evsit dhe Hazrexhit. Kështu disa prej tyre dëshmuar se e kanë pranuar Islamin dhe filluan të shtinë risi të cilat nuk i takojnë Islamit. Disa të tjerë u përpoqën që t’i bëjnë dëm Islamit duke treguar përralla të ndryshme, duke provokuar dyshime dhe duke i “bllokuar” muslimanët me pyetjet:

-Ç’është Zoti?

-Ç’është shpirti?

-Nëse Zoti krijoi të krijuarën, kush krijoi Zotin? etj...

Kur Muhammedi ﷺ hyri në konflikt me Kurejshët te Bedri, armiqtë lëshuan parulla të rrejshme se i Dërguari ﷺ ka vdekur, ndërsa kur muslimanët fituan në Bedër, poeti kundërshtar Ka’b ibn

Eshref shkoi në Mekkë dhe recitoi poema mallëngjyese për idhujtarët e vrarë duke i nxitur Arabët jomuslimanë në mobilizim kundër Muhammedit ﷺ.

Muhammedi ﷺ kishte lidhur marrëveshje me kundërshtarët për paqë, megjithatë disa prej tyre vendosën që të luftojnë kundër tij dhe ithtarëve, dhe kështu i dërguan përfaqësuesit e tyre te ai në kohën e negociatave, të cilat mbaheshin pas fitores së muslimanëve në betejën e Bedrit. Përfaqësuesit duheshin t'ia përcjellin Muhammedit ﷺ këto fjalë:

“O Muhammed, mos u mashtro nga mendimi se je ndeshur me një popull që nuk e do luftën, sepse për Zotin, nëse fillojmë luftën me ty do ta kuptosh se jemi vërtet të fuqishëm...”

Shihet qartë se Muhammedit ﷺ nuk i ngeli asgjë tjetër pos luftës. Ai i rrethoi në kështjellën Kajnukau. Rrethimi zgjati 15 ditë. Askush nuk mundej t'u dërgojë ushqim. Ata u dorëzuan dhe i pranuan kushtet që ua parashtroi Muhammedi ﷺ: që ta braktisin qytetin, t'i dorëzojnë armët dhe të shpërngulen në Siri.

Diçka më vonë vjen deri te dështimi i papritur i muslimanëve në Uhud... Me këtë rast udhëheqësit e fisit Benu Nadir përgatitën një komplot kundër Muhammedit ﷺ, që ta hedhin me shkëmbij kur do të vijë në qytet për marrëveshje. Muhammedi ﷺ u dërgoi letër pak kohë para realizimit të aktit tradhëtar dhe e dërgoi atë me anë të korierit të tij, ku shkroi:

“Lëshojeni tokën time, sepse thyet marrëveshjen duke dashur ta kryeni tradhëtinë që mjaft mirë e dini. Ju jap afat 10 ditë. Kush do të vërehet pas kalimit të këtij afati do të jetë i vrarë.

Megjithatë, të nxitur nga Abdullah ibn ebi Seluli, i cili u tha se do t'u ndihmojë, e kaluan afatin e dhënë. Kaluan 10 ditë e ata ende nuk i kishin lëshuar shtëpitë.

Muslimanët morën armët dhe i luftuan 20 ditë...

Ata pritnin ndihmën e aleatit të tyre, ibn Selulit, por ky nuk mbajti fjalën e dhënë. Atëherë kërkuan nga Muhammedi ﷺ që t'ua sigurojë jetën dhe pasurinë, atyre dhe të afërmëve, që të dalin nga kështjella dhe qyteti. Muhammedi ﷺ lidhi marrëveshje me ta. Sipas kësaj marrëveshjeje u precizua që çdo tre veta që do të dalin nga qyteti do të kenë të drejtë të marrin me vete ujë dhe deve aq sa duan nga pasuria dhe ushqimi, por asgjë tjetër.

Ata dolën dhe lanë pas drithërat, 50.000 mburoja, 350 shpata dhe tokë punuese, të cilën i Dërguari ﷺ e shndërroi në pronë të muhaxhirëve (emigruesve) dhe të vobektëve. Udhëheqësi i tyre Hajj ibn Ahtab vazhdoi t'i nxisë arabët kundër Muhammedit ﷺ në mobilizimin e fiseve Kurejsh, Gatafan, Beni Murr dhe Beni Fezare, dhe u ipte kurajo fiseve Veslin dhe Esed të cilat përpiqeshin t'u hakmirren muslimanëve.

I mblodhën edhe 10.000 luftëtarë dhe u nisën në luftë kundër Medinës, në betejën e quajtur “Ahzab”.

Muhammedi ﷺ urdhëroi që të gropohen kanale mbrojtëse ndërmjet qytetit dhe sulmuesve, duke menduar se pas shpine janë të sigurtë (për shkak se e kishin lidhur marrëveshjen me fisin Beni Kurejdha në Medinë). Megjithatë, Hajj ibn Ahtabi ua mbushi mendjen miqëve të tij, nga fisi Beni Kurejdha që ta thejnë marrëveshjen me Muhammedin ﷺ ndërsa udhëheqësit të këtij fisi, Kab ibn Esvedit, kur e pa se po hamendej, i tha:

“Mjerë për ty, o Kab! Të erdha në një moment (të rëndësishëm) nga i cili varet ardhmëria, ta solla ushtrinë sa një det, ti solla Kurejshët, Gatafanët, komandantët dhe zotrinjtë e tyre! Me të gjithë

lidha marrëveshje se nuk do ta lëshojnë betejën derisa ta shkatërrojnë Muhammedin dhe ata që janë me të!”

Ai ia përshkruan Ka’bit potencialin ushtarak të forcave aleate, numrin e tyre dhe gatshmërinë e tyre luftarake. Gjithashtu e cekë se vetëm kanali rreth Medinës i ka penguar që ta likuidojnë Muhammedin ﷺ dhe të mos ishte kanali, ata qëmoti do ta kishin likuiduar.

Ka’bi në moment dyshoi dhe pyeti:

“Por çfarë do të ndodhë nëse aleatët na e kthejnë shpinën dhe na lënë të vetmuar që të na hakmirret Muhammedi?”

Hajj ibn Ahtab iu përgjigj, duke shtrënguar grushtin:

“Sillni të gjitha forcat e juaja, pastaj do ta ndaj ardhmërinë me ju!...”

Ka’bi e pranoi këtë propozim, e theu marrëveshjen me muslimanët dhe u kthye në anën e Hajj ibn Ahtabit. Muhammedi ﷺ e dërgoi përfaqësuesin e vet që të njohtohet me të vërtetën, ndërsa Ka’bi iu përgjigj:

“Nuk ka asnjë marrëveshje mes nesh dhe jush...” duke e sharë Muhammedin ﷺ me fjalë ofenduese.

Aleatët e forcuan prapavijën, dërguan 3 bataljone, të cilët iu turrën muslimanëve si ndonjë vërshim. Ishin këta bataljoni i ibn el-E’avar es-Selmit mbi kodrën (pranë qytetit), bataljoni i Ujejn ibn el-Hisnit prej anash, ndërsa ushtria e Ebu Sufjanit mbi kanalin.

Në lidhje me këtë ndodhi trishtuese u shpallën ajetet:

“Kur ata ju erdhën prej së larti edhe prej së poshti, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të lloj - llojta për All-llahun. Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë. Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thonin: “All-llahu dhe i dërguari i Tij nuk na premtuan tjetër gjë pos mashtrimit! Dhe kur një grup prej tyre thanë: “O banorë të Jethribit, nuk ka qëndresë për ju, ndaj kthehuni!” E një grup prej tyre kërkonin lejën e Lajmëtarit, duke thënë: “shtëpitë tona janë të pambrojtura!” Edhe pse ato nuk ishin të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër pos ikjes!<sup>xl</sup>

Frika ndër muslimanët arriti kulminacionin. Disa prej tyre i përshpëritnin njëri - tjetrit: “Muhammedi na premtoi se do ta kemi thesarin e mbretit persian dhe të atij bizantin, ndërsa sot asnjë prej nesh nuk është i sigurtë për veten as atëherë kur shkon për ta kryer nevojën!”

Disa prej kalorësve Kurejshë kërkonin pikat e dobëta të kanalit që të depërtonin përtej tij... Ali ibn Ebu Talibi ﷺ turrej me disa muslimanë të tjerë që t’ua zaptojnë hyrjen. Kalorësi Kurejsh Amër ibn Abd kaloi kanalën. Këtu ndodhi një kacafytje e tmerrshme, në të cilën Aliu ﷺ ia preu kokën me një të rënë të shpatës.

Neufel ibn Abdull-llah ibn el-Mugire u përpoq që të depërtojë përtej kanalit duke e kapërcyer atë me kalë, por u rrëzua në të dhe u bë copë-copë.

Dielli i afrohej perëndimit. Muslimanët u pajtuan me faktin se janë të rrethuar prej armiqëve nga të gjitha anët, të cilët kishin përgatitje më të mirë ushtarake.

Atëherë Na'im ibn Mes'udit iu kujtua një lajkë. Fisi i tij dhe kundërshtarët tjerë nuk e dinin se ai e ka pranuar Islamin. Ai shkoi deri te përfaqësuesit e fisit të vet dhe i frikësoi me thyerje të marrëveshjes nga ana e aleatëve duke u thënë se ata nuk do të qëndrojnë më nën rrethim. Për këtë shkak u propozoi të kërkojnë disa ushtarë nga ushtria aleate që së bashku me ta të luftojnë kundër Muhammedit ﷺ. Në këtë mënyrë do të jenë të siguar nga tradhëtia e fiseve Kurejsh dhe Gatafan.

Pastaj ibn Mes'udi depërtoi edhe deri te Kurejshët dhe ua tërhoqi vërejtjen nga rreziku i tradhëtisë të fisit Benu Kurejdha, se ata do të kërkojnë disa ushtarë si peng që të jenë të sigurtë, dhe se ata në të vërtetë do t'ia dorëzojnë ushtarët Muhammedit ﷺ që ai t'i vrasë, dhe kështu t'i shmangen përgjegjësisë për atë që e kanë thyer marrëveshjen me të.

Dyshimi ia shtrëngoi zemrën Ebu Sufjanit. Ai kërkoj nga kryetari i fisit Benu Kurejdh që ta shpejtojë luftën, ndërsa ky fis (Benu Kurejdh) i kërkoj falje për shkak të së shtunës (të cilën e kishin ditë feste) dhe kërkuan disa ushtarë si peng me pretekst se duan të jenë të sigurtë se beteja do të vazhdojë. Tani më askush nuk dyshonte në vërtetësinë e fjalëve të Na'imit... Ai të njejtin verzion ia përcollti edhe fisit Gatafan. Kur dëgjuan këtë, ithtarët e fisit Gatafan filluan të hamenden, të luftojnë ose jo, sepse i lakmuan ofertës së Muhammedit ﷺ se do t'ua japë një të tretën e të ardhurave vjetore (nga frutet) e Medinës nëse i tërë fisi nuk paraqitet në luftë.

Filloi të fryejë një fortunë e ftohtë me borë. Më vonë ra edhe shi. Rrufetë u tërbuan. Fryu erë e fortë, e cila ua shpërndau çadrat e ushtarëve aleatë. Forca e aleatëve filloi të dobësohet. U duk se muslimanët çdo moment do t'u turren. Ebu Sufjani thërriti:

“O Kurejshë, për Zotin ju më nuk jeni në vend të sigurtë... na humbi prej dore çdo gjë. Kurejdhet na e thyen marrëveshjen. Morëm vesh se po na përgatisin tradhëti!. Na zuri erë e fortë! Çfarë mendoni? Kthehuni!... Unë po kthehem...”

Zulejh ibn Huvejlid thërriti: “Shpëtoni veten, shpëtoni veten! Muhammedi dëshiron t’ju shkaktojë dëm!”

Agoi. Arabët Kurejshë ikën në Mekkë. Fusha e betejës u zbraz. Në të ngelëzn vetëm muslimanët dhe kundërshtarët e tyre nga fisi Benu Kurejdh ballë për ballë.

Muslimanët e rrethuan këtë fis 20 ditë. Kështu të rrethuar nuk kishin zgjidhje tjetër pos dorëzimit. Ata e zgjodhën Se’ad ibn Muadh el Evsin qzë t’u gjykojë, i cili ishte një mik i vjetër i tyre. Ai u urdhëroi që t’i dorëzojnë armët, dhe ata e bënë këtë. Gjithashtu gjykoi që të vriten disa luftëtarë, të shpërndahet pasuria e tyre, ndërsa fëmijët dhe gratë të mirren për robër. I pari që e vranë ishte Hajj ibn Ahtab.

Pak më larg Medinës, ngeli vetëm edhe Hajberi - kështjella kundërshtare me mure të forta. Ishte kjo kolonia më e madhe, më e pasur dhe më e armatosur kundërshtare. Ajo ishte burim i kërcënimit permanent nga veriu.

Muhammedi ﷺ u nis me 1700 luftëtarë kah Hajberi, një muaj pas lidhjes së marrëveshjes me Kurejshët në Hudejbije. Kur mbërriu pranë fortesës thërriti:

“All-llahu është më i madhi! Hajberi po rrëzohet! Kur paraqitemi në fushëbetejë kundër ndonjë populli, mëngjez i kobshëm agon për ta!”

Filloi një luftë e ashpër pranë fortesës së parë. Muhammedi ﷺ e dërgoi Ebu Bekrin ﷺ kah fortesa, i cili luftoi një ditë të tërë, por nuk e pushtoi; pastaj dërgoi Umer ibn Hatabin ﷺ, por as ai nuk pati fat më të mirë se Ebu Bekri. Atëherë u nis Ali ibn Ebu Talib ﷺ me flamur në dorë. Shkoi përpara dhe i turr armiqëve duke u shkaktuar një luftë të ashpër. Një nga kundërshtarët i ra aq fortë, saqë ia rrëzoi mburojën nga dora. Aliu u kap për derën e fortesës dhe filloi ta shërbejë si mbrojtje gjatë tërë luftimit, derisa depërtoi në kështjellë. Pastaj shtroi derën dhe e bëri si urë nëpërmjet të së cilës muslimanët filluan të hyjnë brenda.

Ra fortesa e parë pas vrasjes së Selam ibn Meshkemit, si dhe komandantit të tij Harith ibn ebi Zejneb.

Edhe pranë fortesës së dytë u krijua një luftë e ashpër. Muslimanëve filloi t'u pakësohet ushqimi. I Dërguari ﷺ u lejoi atyre që të ushqehen me mishin e kuajve.

Një nga kalorësit kundërshtarë i quajtur Murhab recitoi vjershën:

“Gjith Hajberi e di  
se unë jam Murhabi;  
i armatosur, hero me përvojë  
herë sulmoj e herë lëndo!”

Ibn Meslemi iu kundërshtua. Filloi dyluftimi. Të mos mbrohej Meslemi me mburojën e lëkurës nga të rënat e shpatës së Murhabit, do ta kishte humbur jetën. Për fat shpata e Murhabit depërtoi

në mburojën e lëkurës së Meslemit. Lëkura e shtrëngoi dhe nuk ia lëshoi shpatën. Këtë e shfrytëzoi ibn Meslemi dhe kundërshtarit të tij ia ktheu me disa të rëna vdekjepruese.

Muslimanët filluan të përparojnë hap pas hapi duke luftuar ballë për ballë. Më në fund ranë të gjitha fortesat, kështuqë armiku ishte i detyruar të kërkojë paqen.

Pas lidhjes së marrëveshjes për paqë, Zejnebe ibn el Harithi<sup>xli</sup>, që të hakmirret për burrin dhe babanë, dy njerëzit më të dashur në jetën e saj, ia dhuroi të Dërguarit ﷺ një dele të helmuar. I Dërguari ﷺ mori një kafshatë, por nuk e përtypi atë, dhe tha:

-Kjo është po më thotë se mishi është i helmuar! Beshir ibn el-Bera hëngri vetëm pak, dhe ra i helmuar. I dërguari e thirri Zejneben. Ajo e pranoi se e ka helmuar mishin me këto fjalë:

“E bëra atë që për ty nuk është fshehtësi! I thash vetes: nëse është vetëm udhëheqës, me vdekjen e tij do të rehatosemi, por nëse është i dërguar, do ta lajmërojë Shpallja e tij.”

I Dërguari ﷺ ia fali, duke pasur parasysh atë që i ndodhi burrit dhe babait të saj.

Në këtë betejë u zu rob edhe Safija, vajza e Hajj ibn Ahtabit. I Dërguari ﷺ e mori atë për grua<sup>xlii</sup>. Ky veprim i frikësoi muslimanët... Filluan të përshpërisin ndërmjet veti:

“I dërguari memzi shpëtoi nga delja e helmuar, ndërsa tash e merr Safijen për grua. Babai i saj, Hajj ibn Ahtabi ishte njeriu i parë që u likuidua pas betejës. Gjithashtu edhe ushtarët e tij ranë nga shpatat e muslimanëve. Diçka para kësaj që i shkatërruar edhe fisi Benu Kurejdh... Si mund të jetë Muhammedi ﷺ tani i sigurtë, kur në praninë e vet ka këtë grua?...”

Kush ishte Safija?

Thonë se prejardhja i rridhte që nga Lajmëtari Harun, vëllai i Musait عليه السلام, se është krenare dhe mendjemadhe, dhe se asnjëherë nuk e harron dëmin që ia ka shkaktuar dikush... Nuk kishin kaluar as disa orë që muslimanët ia kishin vrarë burrin pranë fortesës “Hajber”!

Një nga shokët më të ngushtë të Muhammedit عليه السلام, Ebu Ejjub Halidi ruajti tërë natën pranë çadrës të “posamartuarve”, syçelë dhe i gatshëm për ta mbrojtur njeriun më të dashur...

Kur agoi, i Dërguari عليه السلام e pa se po rrotullohej rreth çadrës dhe i tha:

“Çka ke o Ebu Ejjub?” Ai tha:

“O i Dërguar i All-llahut, u frigova për ty për shkak të kësaj gruaje, sepse ne ia kemi vrarë burrin dhe babain, ndërsa popullin ia kemi nënshtruar. Pak më parë që pabesimtare, prandaj u frigova për ty.”

I Dërguari عليه السلام iu drejtua Zotit, që ta mbrojë Ebu Ejjubin me këto fjalë:

“O Zot, ruaje Ebu Ejjubin ashtu siç e kaloi ai tërë natën syçelë duke më ruajtur.”

Lexuesit e biografisë së Muhammedit عليه السلام qëndrojnë të shtangur pranë kësaj martese. Si mund të zhvillohet një dashuri dhe mëshirë mes kësaj gruaje ndaj këtij njeriu duke i kapërcyer të gjitha këto dëme dhe pakënaqësi?

Ne të gjitha biografitë e Muhammedit ﷺ theksohet se Safija e donte të Dërguarin ﷺ por edhe ai e ka dashur atë, dhe se i ka qortuar ngacmimet e Aishes dhe Hafsës<sup>xliii</sup> të drejuara kah ajo. Kur ato e thirrnin “Çifute” ajo vinte te i Dërguari ﷺ duke qarë, ndërsa ai ia fshinte lotët duke i thënë: “Thuaju: Si mund të jeni më të mira se unë, kur babai im është Haruni, xhaxhai im Musa, ndërsa burri im Muhammedi?”

Gjatë kohës kur u sëmur Muhammedi ﷺ atë e shihje si rri vigjilente mbi krevatin e tij duke pëshpëritur e përlotur:

“Pasha All-llahun, do të kisha dashur që kjo të më ndodhte mua, e jo ty, o i dërguar i All-llahut!”

Gratë e të Dërguarit ia mbyllën syrin njëra-tjetrës në shenjë përqeshjeje. Kur e vëreu këtë, i Dërguari ua tërhoqi vërejtjen:

“Po ia mbyllni syrin njëra - tjetrës, nuk i besoni... Megjithatë, për Zotin ajo është e sinqertë.”

Së fundi, të kishte ngelur urrejtja te Safija, ajo do ta nxirrte në shesh menjëherë pasi që ndërroi jetë i Dërguari ﷺ, kur muslimanët u përçanë dhe u paraqitën turbullirat. Në atë kohë, kur disa prej njerëzve u tubuan kundër Uthman ibn Afanit, Safija e para ndër muslimanët u nis që t'i qetësojë turbullirat. Në rrugë e takoi El-Eshteri derisa ajo ishte duke kaluar me fytyrë të mbuluar në deve. El-Eshteri i ra deves në turi duke mos ditur se kush është duke e kaluar. Ajo trimërisht i bërtiti: “Mjerë ti! Lëshomë, mos më turpëro!”

Veprat biografike mbi Muhammedin ﷺ na tregojnë se ajo vendosi një urë mes shtëpisë së vetë dhe të Uthmanit ﷺ që t'ia dorëzojë ushqimin në kohën kur ai ishte i ngjuar (i xhindosur).

Ajo e donte të Dërguarin ﷺ por e donte edhe fenë, ashtu që sakrifikoi veten deri në fund të jetës.

Këtu ndalet lexuesi që lexon me vëmendje, duke u pyetur i habitur: Si mundej dashuria e saj ta tejkalojë atë det prej gjaku? Si e tejkaloj kjo dashuri krenarinë e prejardhjes, lidhjes me popullin e vet, babain dhe të afërmit tjerë, të cilët u vranë në luftë kundër Islamit dhe Muhammedit ﷺ?

Përgjigjen mund ta gjesh vetëm në Muhammedin ﷺ, në shpirtin i cili shkëlqen dhe të robëron në zemrën e tij të mirë dhe fisnike, në atë fuqi ngadhënjimtare, në ndihmën hyjnore që ia dha All-lahu që t'i përfitojë zemrat e armiqëve dhe t'i pastrojë nga urrejtja...

Përgjigja gjindet në profetësinë. Vetëm kjo mund ta spjegojë këtë fenomen, e jo madhështia. Kjo është ajo fuqi e jashtzakonshme.

Ndodhia me Safinë i thyen akuzat e drejtuara ndaj të Dërguarit ﷺ se marëdhëniet me gratë e tija janë bazuar në epshe, dhe se të nëntë martesat e tija kanë filluar nga tërheqja e epshit.

Është e njohur se epshi asnjëherë nuk e pastron shpirtin e njeriut. Përkundrazi, ai e nguron shpirtin dhe e hedh sa më tepër në errësirë. Këtu ne hasim një dashuri të bazuar në fisnikëri, bujari, butësi dhe mëshirë. Sipas kësaj, lidhja e martesës së të Dërguarit ﷺ me cilëndo prej grave ishte vetëm ofrim dashurie, ndërsa në disa raste si motivim ishte humaniteti ose qëllimi i arritjes së pajtimit (me fisin e saj).

Me disa nga gratë me të cilat u martua, ai njëkohësisht pranonte një barrë të rëndë dhe përgjegjësi, sepse disa prej tyre i mirrte edhe me familjet e veta. Të gjitha ato kishin qenë edhe më parë të martuara, përveç Aishes. Kjo vërtet ishte ngarkesë e rëndë!

Çdonjë prej nesh kohë pas kohe përjeton ndonjë vështirësi për shkak të gruas së vetme, fëmijëve ose familjes. Ndonjëherë ajo të hidhëron ose ta humb disponimin. Por çfarë është ajo zemër, që e ka atë forcë t'u dalë ballë nëntë grave me familjet e tyre, duke ia shtuar kësaj ngatërresat e kohë pas kohëshme, shqetësimet dhe dëshirat e kundërta? Ku është këtu epshi? Kjo gjithsesi ishte një sprovim. Një kontrollë e shkollës së bujarisë, butësisë, durimit, qetësisë, qëndrueshmërisë, kontrollë ndaj shpirtit fisnik, në të cilin nuk ka vend për zili.

## **MËSHIRË NDAJ KRIJESAVE**

Të ndalemi pak në këtë shpirt të pastër, duke e vëzhguar nga një moment tjetër madhështor, me të treguarit e dyfytërisë së Abdull-llah ibn Ebu Selulit, kur ai bëri ngatërresa mes fiseve Evs dhe Hazrexh dhe turbullirën që e shkaktoi mes muxhahirëve dhe ensarëve në Medinë.

“Muhaxhirët na e kaluan me numër në shtëpiat tona në Medinë...” thoshte “...Sot në krahasim me ta jemi ashtu siç thotë fjala e urtë: Ushqeje qenin që të të kafshojë. Dijeni se, pasha Zotin, nëse rikthehemi në Medinë, i poshtri do ta shporrë fisnikun. Këtë ia bëtë vetes! Ua dhatë qytetin tuaj! E ndatë me ta pasurinë tuaj, ndërsa për Zotin, nëse nuk do t'ua ipnit, do të shkonin në ndonjë vend tjetër!”

Kjo përçarje e Selulit u kanos që ta shkatërrojë tërë shoqërinë Islame.

Të gjithë qenë të bindur se Muhammedi ﷺ do të urdhërojë që ibn Seluli të likuidohet.

Abdull-llahu, i biri i ibn Selulit shkoi shpejt te i Dërguari ﷺ dhe e luti: “O i Dërguar i All-llahut, nëse do të urdhërosh diçka për babain tim, urdhëromë mua, unë do ta sjellë kokën e tij... Pasha All-llahun, fisi Hazrexh e di se askush në vend nuk i ka bërë prindit të vet më tepër të mira sesa unë. Unë frikësohem se mos po e urdhëron dikë tjetër të vrasë babain tim. Në atë rast vetëdija ime nuk do të më lë që vrasësi i babait të hecë i gjallë. Ajo do të më shtyjë ta vras njeriun besimtar për shkak të një pabesimtari, e pastaj të futem në zjarr!”

Si iu përgjigj i Dërguari ﷺ këtij njeriu fisnik i cili qe i mërzhitur për babain, por më tepër për fenë e tij?

I tha:

“Jo, bir! Nuk do ta vrasim, por do ta këshillojmë me butësi, për shkak se ai ngeli me ne.”

I Dërguari ﷺ bëri edhe më tepër se kjo. Kur vdiq ibn Seluli, e mbështolli me këmishën e tij galebije (e shfrytëzoi si qefin) dhe u lut për të, ndërsa kur do t’i kujtohej ky rast më vonë, do të thoshte i përlotur:

“Për Zotin, këmisha ime nuk do ta shpëtojë nëse vetë All-llahu nuk do t’ia falë mëkatin e rëndë për përçarje. Për Zotin, jam i gatshëm të kërkoj falje për të edhe 70 herë, nëse do ta dija se ajo do ta shpëtojë.”

Këtë mund ta bëjë vetëm Lajmëtari i Zotit, i dërguar si mëshirë për çdo krijesë.

## EKSPEDITA E PAFRENUESHME CILËSITË E THIRRJES SË TIJ

Thirrja në Islam është tejet e thjeshtë. Ajo është e natyrëshme dhe pa asnjë ngarkim. Muhammedi ﷺ nuk i thërriste njerëzit në lavirantin e pazgjedhur teologjik, e as nuk i shtyente që të bëjnë grushtet mbi sistemin e Kurejshëve, por dëshironte që ta pastrojnë mendjen prej adhurimit të idhujve.

Thirrja e tij në Islam ishte në thelb thirrje kah liria, sepse idhujt nuk mund ta mbrojnë njeriun ose t'i sjellin ndonjë dobi. Njeriu duhet të çlirohet nga këto, t'i hedhë pas shpine, e jo të presë kurban për to, t'u lutet, t'u falenderohet, t'u kërkojë falje ose t'u kërkojë ndërmjetësim; por t'i lutet Zotit të vetëm, të cilit nuk i përngjan asgjë.<sup>xliv</sup>

Thirrja e tij në Islam dhe ideja e Një Zoti ishte qëllimi përfundimtar, i cili arrihet mes persiatjes së drejtë mbi fenomenet e betejave. Të gjithë shkaktarët më në fund bazohen në një shkak, i cili është lëvizës i të gjitha atyre.

Thirrja e tij në Islam ishte një edukatë etike, e cila përpiqej për të mirën, drejtësinë dhe dashurinë. Ai thirrte në shpëtimin e të varfërve, të sëmurëve, jetimëve dhe të vejave.

Në të njëjtën kohë gruaja në Europë e kishte arritur atë gradë, që burri i saj i vinte rreth barkut një brez të hekurt me parashtysa, të quajtur “brezi i virgjinitetit” që ta sigurojë nderin e saj, sikur të ishte ajo një mobilje e thjeshtë. Në kohën paraislamike arabët femrat i varrosnin të gjalla, posa

kishin lindur, ndërsa ato që kishin fat të mos vriten, kur rriteshin i shitnin si robëresha. Në Indi gruaja digjej e gjallë pranë trupit të burrit të vdekur.

Islami ia dha gruas të drejtën, por edhe detyrën. E nderoi atë si fëmijë, si vajzë, si bashkëshorte dhe si nënë.

Muhammedi ﷺ nuk kundërshtoi fenë e mëparshme të Ibrahimit, Musait dhe Isait, por e përkrahu, e konfirmoi dhe e plotësoi.

Muhammedi ﷺ thirrte në mirësi, por u ndesh me rezistencë të zjarrtë nga të gjithë. Dhe atëherë i erdhi shpallja që të thërrasë në Islam:

“Tërhiqja vërejtjen farefisit tënd më të afërt, dhe të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan!”  
xlv

Muhammedi ﷺ u ngjit në shkëmbin Safa (në Mekkë) dhe thirri:

“O Kurejshë! Nëse ju them se nën këtë shkëmb gjendet një kalë, a do të më kishit besuar?”

Thanë: “Po, se ti mes nesh nuk je i dyshimtë, ne asnjëherë nuk të kemi dëgjuar se gënjen!”

“Atëherë po ju tërheq vëmendjen me një dënim të dhembshëm, o pasardhësit e Abdul - Mutalibit, pasardhës të Abdul Menafit, Zehrës, Temimit, Mahzumit, Esadit e të tjerë, se All-llahu më ka urdhëruar që t’ia tërheq vëmendjen farefisit... Unë nuk mund t’ju jap kurrfarë dobie të kësaj jete ose të amshueshmërisë, derisa ju nuk dëshmoni se All-llahu është Një dhe i Vetëm.”

Ebu Lehebi këceu ashtu siç ishte trashanak dhe thërriti:

“Të qoftë kjo ditë e zezë! Po a për këtë na tubove?”

Kërkonin prej tij që të bëjë ndonjë vepër mbinatyrore: t’u sjellë burime nga toka, t’u japë kopshte dhe lumenj, ta shtrojë Safën dhe Merven<sup>xlvi</sup> me ar, t’i ngjallë të vdekurit, t’i kaplojë errësira ose shiu i gurëve nga qielli, t’u lëshohet libri i shkruar në pergament të cilin do ta shihnin me sy, ose t’ua sjellë All-llahun dhe engjujt...

Atëherë u shpall:

“Dhe thonë: -Nuk të besojmë derisa të na nxjerrësh kroje nga toka; derisa të kesh kopsht me palma (hurma) dhe hardhi (rrush), dhe të bësh të rrjedhin lumenj mes tyre; ose ta coptosh qiellin mbi ne siç po pohon vetë, apo të na sjellësh All-llahun dhe engjëjt pranë nesh; ose derisa të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh në qiell, por edhe sikur të ngjitesh, ne nuk do të besojmë derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë! Thuaj: I Madhëruar është All-llahu! Mos jam unë tjetër pos Lajmëtar?”<sup>xlvi</sup>

“Thuaj: Unë nuk kam mundësi që t’i siguroj vetes ndonjë dobi, e as t’ia largoj vetes ndonjë dëm, pos asaj që do All-llahu. Sikur ta dija të fshehtëm, do të fitoja shumë të mira dhe nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër pos qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë.”<sup>xlvi</sup>

“Thuaj: Unë nuk ju them: ‘Te unë janë depotë e All-llahut’, ose: ‘Unë di të fshehtëm’, e as që po ju them: ‘Unë jam engjëll!’ Unë ndjek vetëm atë që më shpallet. Thuaj: ‘A janë të barabartë i verbëri me atë që sheh?’ A nuk mendoni?”<sup>xlvi</sup>

Ndërsa ata e akuzuan se është magjistar, i çmendur, prift-parashikues, i shtynë poetët që ta tallin, ta luftojnë, ndërsa të çmendurit t'ia gurëzojnë shtëpinë. Mundimet që i përjetuan ithtarët e tij ishin shumë më të mëdha se ajo që e përjetoi ai vetë.

Më vonë filluan të përgadisin komplot kundër tij. Xhaxhai i tij, Ebu Talibi vendosi që të dalë në anën e tij. Ai i thërriti Hashimitë dhe Mutalibët që ta mbrojnë Muhammedin ﷺ nga Kurejshët. Të gjithë pranuan pos Ebu Lehebit. Ai ngeli i vendosur në armiqësinë e tij dhe iu bashkangjiti kundërshtarëve të Muhammedit ﷺ.

Mu atëherë filloi periudha e qëndrueshmërisë dhe luftës pasive ndaj mundimeve të njëpasnjëshme.

## **DURIMI I MUNDIMEVE - NË DOBI TË THIRRJES**

Ebu Talibi,<sup>1</sup> i cili mbronte Muhammedin ﷺ u ndesh me urrejtjen e Kurejshëve, të cilët herë i kërcënoheshin, e herë i premtinin:

“O Ebu Talib, ti je i moçëm, fisnik dhe i respektuar mes nesh. Ne kërkuam nga ti që t’ia ndalosh nipit tënd thirrjen në Islam. Ti nuk e bërë këtë. Për Zotin, ne nuk mundemi të durojmë që të na i tallë prindërit, të na bëjë budallenjë dhe t’ua gjejë të metat zotërave tonë (idhujve). Detyra yte është që ta pengosh në këtë, ose do të fillojmë një luftë të hapët kundër jush, dhe do të qëndrojmë ashtu derisa njëri nga dy grupet do të dëbohet.”

Ebu Talibin e zu dobësia. Ai iu drejtua Muhammedit ﷺ me këto fjalë:

“Më le mua rahat, por edhe vetë shmangu (nga kjo që po e bën)! Mos më rëndo me atë që nuk mund ta mbaj!”

Ndërsa Muhammedi ﷺ iu përgjigj me qetësi dhe urtësi:

“O xhaxha! Pasha Zotin, nëse do të ma vënë Diellin në dorën e djathë, ndërsa Hënë në të majtën, me kusht që ta braktis këtë thirrje, unë nuk do ta lë, derisa ta përcaktojë Zoti fitoren ose dështimin.”

Xhaxhai i tij e pëlqeu këtë trimëri dhe vendosmëri, e puthi nipin e tij me kënaqësi dhe i tha:

“Shko dhe thirr në atë që do. Për Zotin, unë nuk do të braktis asnjëherë dhe për asgjë, nuk do ta pranoj atë që ti e urren.”

Nuk kaluan disa ditë kur një grup i vogël prej fisit Kurejsh erdhi te Muhammedi ﷺ me një propozim tjetër, por me qëllimin e njejtë - ta pengojnë në thirrje për Islam. Këtë rradhë ata e kishin angazhuar 'Atabe ibn Rebian t'i ofrojë Muhammedit ﷺ një ofertë të madhe. Ai i tha Muhammedit ﷺ :

“O kushëriri im, ti e di se çfarë pozite gëzon te ne, Kurejshët. Ti i solle popullit tënd diçka të madhe, me të cilën shkaktove përçarjen, ndërsa zotërat i ofendove dhe i shpalle të panevojshëm. Më dëgjo! Unë po të ofroj një varg ofertash, ndoshta do të pranosh diçka.

Nëse do pasuri, ne do ta mbledhim atë mes nesh ashtu që do të bëjmë më të pasurin. Nëse do pozitë, do ta japim, do të bëjmë kryetarin tonë, ashtu që asgjë nuk do të bëjmë pa urdhërin tënd. Nëse dëshiron të na bëhesh sundimtar, do ta mundësojmë edhe atë. Nëse ke ndonjë përbindësh (krijesë të padukshme) që e sheh ndërsa nuk mund ta rezistosh, do të kërkojmë ilaç për ty, si dhe do të japim, mjete (financiare) që t'i shpenzosh deri sa të shërohesh...”

Atabe ibn Rebia sa nuk i tha edhe mendimet e fundit, por Muhammedi ﷺ ia lexoi suren “Sexhde” nga Kur’ani si shenjë se nuk dëshiron më ta dëgjojë.

Disa muslimanë, të cilëve shtypja dhe mundimi iu bënë të padurueshëm, u shpërngulën në Abisini, ndërsa Muhammedi ﷺ edhe më tej ngeli në Mekkë me një grup muslimanësh, duke i rezistuar valët e sulmeve të kundërshtarëve të tyre.

Kurejshët filluan të konsultohen. Morën vendim që ta ndërrojnë politikën e tyre ndaj Muhammedit ﷺ dhe ithtarëve të tij. Vendosi që të fillojnë t’i mendojnë me uri, t’i bojkotojnë dhe t’i vënë nën bllokim total. Shkruajtën edhe një mbishkrim për këtë dhe e varën mbi Kaben. Përmbajtja e tij ishte:

“Ndalohet shitblerja me familjen Hashim dhe Mutalib; ndalohet martesë me ta, bashkëpunimi me ta, si dhe me të tjerët që e pasojnë Muhammedin ose që e mbrojnë atë.”

Muhammedi ﷺ, familja e tij dhe shokët e tij kërkuar strehim mes kodrinave pas Mekkës. Ata vuanin nga blokada, të privuar nga çdo gjë. Ushqimi mundej të sigurohet vetëm në mënyrë të fshehtë. Një as’hab këtë periudhë e tregon me pezmatim. Ai thotë se një ditë ishte i uritur aq

shumë saqë kishte filluar të mos shohë. Në një moment dora i kishte prekur diçka të butë, të cilën e kishte shtirë në gojë pa pyetur se çka është.

Bojkoti zgjati 3 vjetë. Muhammedit ﷺ i ishte e lejuar të kontaktojë me njerëzit vetëm në muajin e Haxhxhit. Nga biografia e tij mësojmë se një ditë i ka ardhur një delegacion i të krishterëve, të cilët kanë bujtur te ai, dhe gjatë kohës që kanë ndenjur te ai i kanë parashtruar pyetje dhe i kanë dëgjuar përgjigjet. Anëtarët e delegacionit e kanë pranuar Islamin dhe e kanë dëshmuar këtë pranë të gjithëve. Kurejshët janë hidhëruar në ta dhe i kanë mallkuar duke u thënë:

“Ju tradhëtoi Zoti juaj! Çfarë bëri delegacioni, të cilin e dërguan besimtarët e juaj që t’i raportoni për këtë njeri? Ndërsa ju, anëtarët e delegacionit nuk u ndatë prej tij deri sa e braktisët fenë e juaj dhe deri sa iu përlulet atij!”

Mundet dikush do të pyetet se ku fshihet sekreti i këtij mosdurimi, zënke dhe armiqësie të Kurejshëve ndaj Muhammedit ﷺ, i cili nuk luftoi me askë për ta sunduar ose për ta robëruar. Ai madje do të thoshte:

“Të zgjedhurit e juaj (udhëheqësit) nga periudha paraislamike janë të zgjedhurit e juaj edhe në Islam, nëse u aftësohen mësimëve Islamike...”

Ndërsa kur hyri në Mekke si çlirues, nuk ia ndërroi pozitën e lartë Ebu Sufjanit, por ia përforcoi me atë që i krahasoi refugjatët Kurejsh të cilët u strehuan në shtëpinë e tij me refugjatët që u strehuan në Haremin pranë Kabes.

Atëherë përse nevojiteshin të gjitha këto zënka dhe armiqësi?

Bëhej fjalë për mendjemadhësi mbi mendjemadhësinë... Ebu Xhehli për veten e thoshte këtë:

“Kundërshtoheshim ne dhe Abdumenafët për çështjen e nderit. Ata ipnin ushqim, por edhe ne ipnim, ata shpërndanin, edhe ne shpërndanim, ndërsa kur shkuam aq larg, saqë ishim si dy kuaj që garohen, ata thanë:

‘Nga ne është i Dërguari...’ Dhe kur më kujtohet kjo, për Zotin nuk mund ta pranoj!

Pra, nuk bëhej këtu fjalë për të vërtetën ose rrenën, por për “mua ose atë”.

Së fundi, përse Ebu Xhehli të mos ishte i dërguar?

Pastaj, feja e Muhammedit ﷺ do t'i sillte të pasurit kryelartë në pozitë të pakëndshme dhe do t'i ngushtonte në shumë çështje. Sepse nëse dikush prej tyre do të bënte prostitucion, do të vidhte, do të vriste ose do të bënte ndonjë vepër tjetër amorale, të afërmit e vet do t'u dërgonin ndonjë lloj ryshfeti idhujve dhe me këtë do të lahej mëkati, ndërsa kryesi i mëkatit do të flinte i qetë sikur të ishte fëmijë i posalindur, plotësisht i pastër nga mëkatet. Ndërkaq, Muhammedi ﷺ u kërcënohej se do të ringjallen pas vdekjes, se do të qëndrojnë përballë një dënimi tmerrues dhe se do ta japin llogarinë ku nuk do të lihet pas dore as imtësira më e vogël!

Atë vit vdiq Ebu Talibi, ndërsa pas disa muajsh edhe Hatixhja (gruaja e parë e Muhammedit ﷺ). Këta ishin më të afërmit e Muhammedit ﷺ. Njerëzit filluan të bëhen indiferent ndaj tij. Disa prej tyre i nxitnin të çmendurit që t'i hedhin dhé në kokë, duke e tallur dhe ofenduar. Fatimja ia shpërlante dheun nga koka duke qarë.

Muhammedi ﷺ shkoi në Taif dhe kërkoi ndihmë nga fisi Sekif, por edhe ata i nxitën të çmendurit që ta shajnë dhe ta hedhin me gurë. E lënduan aq shumë saqë i përgjakur filloi të ikë dhe u strehua pranë një muri. Ra i thyer dhe i lodhur, dhe duke e ngritur shiqimin kah qielli u lut me përlësi:

“O Zot, Ty të ankoem për dobësitë e mia, për pafuqinë dhe për mosndikimin ndaj njerëzve. O më i Mëshirshmi! Ti je Sunduesi i të dobëtve, Ti je Sunduesi im. O Zot, kujt më le në besim? Të huajt që më shikon me ftohësi dhe me armiqësi ose armikut, të cilit ia mundësove sundimin mbi mua? Por, nëse Ti o Zot nuk më hidhërohesh, atëherë çdo gjë është në rregull. Megjithatë, më përfshij me mëshirën Tënde! I mbështetem dritës së Fytyrës Tënde, me të cilën e ndriçove errësirën. Mundësoje që edhe kjo, edhe bota tjetër të bëhen skutë e këndshme, dhe mos e zbrit dënimin dhe hidhërimin Tënd mbi mua. Ty të drejtohem, që të jesh i kënaqur me mua. Forca dhe fuqia të takojnë vetëm Ty!”

Pranë tij kaloi një rob i cili i dha pak rrush të freskët. Muhammedi ﷺ zgjati dorën dhe duke thënë “Bismilah...” vazhdoi të hajë.

-Këso fjalësh nuk përdorin banorët e këtij vendi -tha Abasi (robi) dhe pyeti Muhammedin ﷺ prej nga e ka prejardhjen feja e tij. Dikush nga krishterët prezent shtoi se ai është nga Niniva, “nga vendi i Salihut dhe Junusit” Atëherë robi pyeti çuditshëm:

-Si e di ti se kush është Junusi?

-Ai është vëllau im. Ai ishte i dërguar si unë -u përgjigj Muhammedi ﷺ.

Atëherë Abasi u përul që t'ia puthë fytyrën, duart dhe këmbët Muhammedit ﷺ, ndërsa ata që ishin prezent u çuditën se çfarë po bënte ky rob.

## LAJME TË MIRA PËR ISLAMIN

Muhammedi ﷺ filloi t'u prezentohet edhe fiseve tjera arabe. Së pari shkoi te fisi Kind, pastaj me radhë te fisi Kelb, Benu Hanifa, Benu Amir, dhe më së fundi te Benu Sa'sa' por askush nuk e dëgjoi thirrjen e tij. E refuzuan në një mënyrë tejet të vrazhdë.

Fisi Benu Amir e kushtëzoi që ata ta zëvendësojnë në profetësi pas vdekjes së tij, ndërsa kur ai iu përgjigj se kjo çështje i takon vetëm Zotit, se Ai ia jepë profetësinë kujt të dojë, ata e braktisën. Në këtë situatë të vështirë për Muhammedin ﷺ, All-llahu ﷻ e informoi atë për lajmin e këndshëm - udhëtimin në sferat e larta qiellore (Isra dhe Miraxhi)...

Kurejshët nuk i besuan se vërtet pat udhëtuar brenda natës gjer në Jerusalem, pasi që Jerusalemi gjendej disa ditë udhëtimi prej Mekkes. Filluan ta përqeshin duke i thënë se është çmendur.

Një prej pabesimtarëve i tha Ebu Bekrit:

“Shoku yt pohon se brenda natës ka udhëtuar në Jerusalem dhe se është kthyer të njëjtën natë!..”; ndërsa Ebu Bekri ia ktheu:

“Nëse Muhammedi e ka thënë këtë, atëherë është e vërtetë, sepse kur më lajmëroi se po i zbret Kur’ani prej qiellit të shtatë në periudha të ndryshme kohore, unë i besova, e kjo është shumë më tepër nga ajo që ju po i çuditeni!”

Edhe pse Muhammedi ﷺ ua përshkroi rrugën prej Mekkës në Jerusalem në imtësi, si dhe pamjen e jashtme dhe të brendëshme të faltores Aksa që gjendej në Jerusalem, ata përsëri nuk i besuan. Çdo argument ishte i padobishëm...

Pas Israsë erdhi edhe një lajm tjetër i mirë për muslimanët - një grup i fisit Hazrexh nga Medina lidhi marrëveshjen me Muhammedin ﷺ në Akabë se do ta përkrahin.

Abbas ibn Ubade, i cili ishte prezent në lidhjen e kësaj marrëveshjeje u tha me kërcënim:

“O ithtarë të fisit tim! A e dini për çka është kjo marrëveshje me këtë njeri? Po lidhni marrëveshje që të luftoni kundër çdo gjëje që kundërshton thirrjen e tij, të luftoni kundër arabëve dhe joarabëve. Nëse mendoni ta braktisni Muhammedin atë moment kur armiku do t’jua rrezikojë pasurinë dhe fisin, atëherë braktiseni që tani, por nëse mendoni se do ta plotësoni atë për çka u thirrët, qoftë edhe nëse sakrifikoni pasurinë dhe ithtarët e fisit, atëherë pranojeni këtë amanet, sepse ai është për Zotin njeriu më i mirë i kësaj bote dhe botës tjetër.”

“Po e pranojmë...” u përgjigj fisi “...qoftë edhe nëse na dëmtohen pasuria dhe njerëzit.”

Shtrinë duart dhe lidhën kontratën:

“Me vullnet po e lidhim këtë marrëveshje se do të shërbejmë dhe do të kryejmë çdo gjë dhe në çdo kohë, qoftë ajo e këndshme ose e pakëndshme për ne, se do ta flasim të vërtetën kudo që jemi dhe se nuk do t’u frikësohemi qortimeve.”

Kjo ndodhi në mes të natës, jo fort larg Akabës, kur njerëzit flinin në gjumin më të thellë, duke mos ua marrë mendja se ç’po ndodhë me ardhmërinë e tyre.

Ndihma e Medinasve filloi të shtohet. Muslimanët filluan të shpërngulen njëri pas tjetrit. Një natë nga Mekka u shpërngul edhe Muhammedi ﷺ duke lënë Aliun ؑ të mbuluar në shtratin e vet, të cilin idhujtarët u përpoqën ta vrasin duke menduar se është i Dërguari ﷺ.

Në rrugën për Medinë së bashku me Muhammedin ﷺ u nis edhe Ebu Bekri. Rrugës hyrën në një shpellë, të cilën duhej ta shfrytëzonin si strehim të përkohëshëm nga idhujtarët që u vinin pas për t’i likuiduar. Njërit prej idhujtarëve iu kujtua se Muhammedi ﷺ me shokun e tij kishin mundur të fshihen në shpellë, por kur u afruan në hyrjen e shpellës, panë se një pëllumb kishte lëshuar vezë dhe se rrjetat e marimangave ishin të paprekura, që donte të thotë se nuk ka patur mundësi të kalojë dikush, e të mos priset rrjeta e marimangës. Prandaj ata vazhduan të kërkuarit mëtej.

Kur’ani për këtë thotë:

“Në mos e ndihmoni ju atë (*Lajmëtarin*), atë e ndihmon All-llahu: kur ata që nuk besuan e përzunë vetë të dytin, dhe që të dy u gjendën në shpellë, ai i tha shokut të vet:

‘Mos u brengos, All-llahu është me ne!’

Dhe All-llahu zbriti qetësinë mbi të, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; dhe fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e All-llahut është më e larta. All-llahu është i Fuqishmi, i Urti.”<sup>li</sup>

Cila ishte kjo ushtri e padukshme dhe e pahetueshme, me të cilën All-llahu e ndihmoi të dërguarin e Tij? A ishte kjo ushtria e marimangave të cilat i thurrën rrjetat e tyre në hyrjen të shpella; ushtria e pëllumbave të cilët i bënë çerdhet e tyre në hyrjen e shpellës; krijesat e padukshme shpirtërore të cilat i përforcuan zemrën e Muhammedit ﷺ dhe bashkëudhëtarit të tij, ose mundet diçka tjetër të cilën ne nuk e dijmë?! Këtu mendja e njeriut has në kufi që nuk mund ta kalojë. Has në fshehtësinë e Lajmëtarëve, më të cilën dallohet lufta e të dërguarit nga lufta e njerëzve të mëdhenj.

E vërejmë se grupi i njejtë i ensarëve që lidhi marrëveshjen në Akabe tani forcohet me të Dërguarin ﷺ dhe ia vërteton lojalitetin para akcionit heroik në Bedër me këto fjalë:

“Asnjë njeri prej nesh nuk do të ngelë pas... Jemi të durueshëm në luftë dhe të sinqertë gjatë takimit...”

Dhe lufta u ndez ashtu siç thamë, mes Muhammedit ﷺ nga njëra anë dhe Kurejshëve, hebrenjve si dhe arabëve të tjerë nga ana tjetër.

Shënohen edhe beteja të tjera: te Bedri, Uhudi, Hendeku me kundërshtarët Beni Nadir, benu Kurejdh dhe benu Mustalek, të cilat njihen si beteja me rëndësi vendosëse për historinë e njerëzimit.

Ata që luftuan, i kanë gdhendur emrat e tyre në fletën e kohës dhe u bënë legjendarë. Njohtohemi me ata që u plagosën, me ata që qëndruan, me ata që vdiqën, si dhe me ata që ngelën pas ose nuk dolën në luftë, por ngelën nëpër shtëpia... Të gjithë janë të shënuar me të dhënat e tyre: me emrin, mbiemrin, prejardhjen, fisin, kur dhe si kanë vdekur etj...

Koha nuk fshin asgjë.

Shumë libra, duke vërtetuar njëri - tjetrin transmetojnë dhe na e përshkruajnë një fotografi të asaj ekspedite madhështore që mishërohet me realitetin e atëhershëm. Ekspeditë, të cilën e përkrahën dhe e ndihmuan njerëz të rradhitur në një rresht, që shkonin pas njeriut i cili i udhëhiqte me urdhërin e të Lartmadhëruarit.

## MARRËVESHJA NË HUDEJBIJE

Kohë pas kohe ekspedita do të ndalohej që të mblidhte fuqi të reja... Një nga këto momente të vlefshme për t'u analizuar është edhe ndodhia e Hudejbijes.

Muhammedi ﷺ u nis për në Mekkë me 1400 ithtarë të veshur në ihrame<sup>lii</sup> që ta kryejnë Umren. Prej armëve kishin vetëm shpatat në këllëfe. Me vete i kishin marrë edhe 70 deve të cilat do t'i sakrifikonin pranë Kabës. As nuk u shkonte mendja se do të luftonin. Mirëpo, kur Muhammedi ﷺ mbërriu deri te vendi Asfar, takoi një njeri nga fisi benu Ka'b i cili i tha:

“Kurejshët kanë dëgjuar për ekspeditën tënde. Edhe ata kanë dalur nga Mekka të mbështjellur me lëkura tigrash dhe janë vendosur në vendin Dhi-Tuva, duke iu betuar Zotit se ti asnjëherë nuk do të hysh në Mekkë, ndërsa Halid ibn Velidi (i cili akoma nuk e kishte pranuar Islamin) ka mbërrirë me kalorinë Kurejshe deri te vendi Keraul - Kamim”

“Mjerë Kurejshët” tha Muhammedi ﷺ “...Deri tani lufta i ka shkatërruar... Çka do t’u pengonte nëse më linin mua dhe arabët të qetë, dhe nëse arabët më fitojnë, atëherë e kanë dashur fitoren, ndërsa nëse më ndihmon Zoti dhe i munda unë, atëherë shumë prej tyre do ta pranojnë Islamin. Çka mendojnë Kurejshët për mua? Pasha All-llahun, nuk do të pushoj së luftuari për atë që jam dërguar, deri sa Zoti të ma japë fitoren ose të më shkojë koka!”

Kur muslimanët mbërrinë në Hudejbi, devja e Muhammedit ﷺ u gunjëzua. I Dërguari ﷺ tha: “E pengoi Ai, i cili deshti ta pengojë shkuarjen në Mekkë... Pasha Zotin, Kurejshët nuk më kanë thirrur asnjëherë, pos nëse kanë dashur të më lusin për diçka, bile edhe në lidhje fisërore, e unë ua kam dhënë.”

Këtë rradhë ai vendosi të mos luftojë, për hir të muajve të shenjtë, në të cilët është e ndaluar lufta dhe gjakderdhja. Vazhduan bisedimet dyanëshe për paqë. Muslimanët, të tubuar rreth Lajmëtarit ﷺ filluan të mendojnë se ai po e tepron me lëshime.

Umeri ؓ duke mos mundur të përmbahet më, i tha Ebu Bekrit ؓ:

“A nuk është ai i Dërguari i All-llahut? A nuk jemi ne muslimanë? Përse po bëjmë lëshime në fenë tonë?!”

Ebu Bekri e këshilloi:

“Umer, ruaje vendin (shkallën e respektit, të cilën e gëzon tek ne)! Unë vërtet besoj se Muhammedi është i dërguar i Zotit!”

I Dërguari ﷺ kur hetoi protestën e muslimanëve, iu drejtua atyre me durim dhe butësi:

“Unë jam rob i All-llahut dhe i Dërguar i Tij. Asnjëherë nuk do t’i kundërshtohem urdhërit të Tij, ndërsa as Ai nuk do të më lë në vetmi që të humbem.”

Këtu u bë edhe një bisedë interesante gjatë shkruarjes së marrëveshjes... I Dërguari ﷺ e thërriti Aliun ؑ dhe i tha:

-Shkruaj: “Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit...”

Përfaqësuesi i Kurejshëve këceu:

-Ne nuk e njohim atë Mëshirues dhe Mëshirëbërës, por ti shkruaj: Në emër Tënd, o Zoti ynë!”

I Dërguari ﷺ e pranoi këtë dhe tha:

-Shkruaj: “Në emër Tënd, o Zoti ynë. Kjo është marrëveshja që e lidhën i Dërguari i All-llahut dhe Suhejl ibn Amri.”

Suhejli përsëri thërriti:

-Ndal! Të besoja se ti vërtet je i Dërguar i Zotit, nuk do të luftoja kundër teje, por shkruaje emrin tënd dhe të babait.

-Shkruaj!; i tha i Dërguari ﷺ Aliut ﷺ -Kjo është marrëveshja që ka lidhur Muhammed ibn Abdull-llahu...

Marrëveshja parashihte paqë në kohëzgjatje prej dhjetë vitesh, me atë që çdo anëtar i fisit Kurejsh që do t'i vijë Muhammedit ﷺ pa pëlqimin e prindërve (ose kujdestarëve të tij) të jetë i kthyer, ndërsa çdo anëtar i palës së Muhammedit ﷺ që e braktis Islamit dhe shkon te Kurejshët, të mos i kthehet të Dërguarit ﷺ. Marrëveshja gjithashtu u lejonte muslimanëve vizitën e Mekkës në kohë të Haxhxhit dhe Umres.

Muslimanët mendonin se me këtë u janë bërë lëshime të mëdha Kurejshëve, edhe atë pa ndonjë shkak. Megjithatë, ardhmëria do t'ua zbulojë muslimanëve qëllimin dobiprurës të marrëveshjes të cilën i Dërguari ﷺ e nënshkroi me urdhërin e All-llahut, Njohësit të së pranishmes dhe të ardhmes.

Disa anëtarë të fisit Kurejsh që pranuan Islamit lëshuan Mekkën dhe u vendosën në Medinë. I Dërguari ﷺ këta i ktheu fisit të tyre duke iu përmbajtur rregullave të marrëveshjes. Këta, duke menduar se kthyerja te fisi i tyre do të thotë vdekje, formuan grupë të veçantë prej 70 vetash nën udhëheqjen e Ebu Beshirit, dhe u vendosën në vendin el-'Ajs në breg të detit të Kuq, duke sulmuar këtu karvanet Kurejshë që kalonin atypari në rrugën për Siri. Kjo i shtyu Kurejshët vetë ta lusin të Dërguarin ﷺ që këtë grup ta pranojë në Medinë, duke kërkuar të fshihet teksti në marrëveshjen e lidhur, ku lejohej kthimi i muslimanëve që ikin nga Kurejshët.

Kjo marrëveshje ishte edhe njohja e parë publike e shtetit Islamik, ndërsa Muhammedit ﷺ si kryetar të tij. Njëkohësisht, marrëveshja u ipte të drejtë muslimanëve që ta kryejnë Haxhxhin dhe

Umren. Edhe diçka mjaft e rëndësishme ishte se me këtë marrëveshje sigurohej qetësia nga ana jugore, e me këtë u mundësohej muslimanëve t'i ndërmarrin masat e duhura për likuidimin e armikut nga ana veriore. Dhe më në fund, t'i frikësojnë armiqtë më të mëdhenj: Bizantin dhe Persinë në luftën te Mu'temi, për të cilën kemi folur më parë. Me këtë marrëveshje u bë i mundëshëm edhe pushtimi i Tebukut në muajin e vapës më të madhe, kur i Dërguari ﷺ u nis me një ushtri të madhe, të cilën e udhëhiqnin 10.000 kalorës deri te Tebuku. Ushtria bizantine u tërhoq duke kërkuar paqë. Guverneri i Ejlës, princi Johan ibn Ru'ba (i krishter) ia dorëzoi dhuratat të Dërguarit ﷺ dhe ia pagoi xhizjen<sup>liii</sup>, ndërsa i Dërguari ﷺ shkroi një letër garance për të:

“Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Kjo është letër garance nga Zoti dhe Muhammedi, i Dërguari i Zotit ndaj Johan ibn Ru'bait dhe banorëve të Ejlës, anijeve dhe qerreve të tyre në ujë dhe në tokë, se ata kanë sigurimin e Zotit dhe të Muhammedit, si dhe të gjithë banorëve të Sirisë, Jemenit dhe Bahrit që janë me to.”

Ushtria u kthye pa ndeshje ushtarake me Bizantin, e ky ishte shkaku që muslimanët fituan simpatinë e popujve të atyre viseve, si dhe të udhëheqësve të tyre.

Këto janë vetëm disa elemente të rezultateve të marrëveshjes paqësore të Hudejbisë. Pas kësaj shohim të Dërguarin se si gjen kohë për t'u drejtuar letra sunduesve dhe udhëheqësve të tjerë. Ja se ç'i shkroi Heraklit:

“Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Nga Muhammedi, biri i Abdull-llahut, Heraklit të madh të Bizantit. Le të jetë shpëtimi mbi atë që e pason udhëzimin... Të thërras me

thirrjen Islame. Pranoje Islamin, do të jesh i qetë. Zoti do të shpërblejë dyfish. Nëse do të refuzosh, do të bëhesh fajtor, dhe do t'ia ngarkosh vetes mëkatin tënd dhe mëkatin e ithtarëve të tu...”

Është për t'u çuditur se si iu drejtua Muhammedi ﷺ Heraklit. A thua ai kishte fuqi që t'i kundërvihet një fuqie si Bizanti? Kjo gjithsesi ishte nga largpamësia e Lajmëtarit ﷺ, të cilën ia dhuroi Zoti, e cila zbuloi në Heraklin një rrjetë më të dobët se të marimangës, që nuk ka asnjë vlerë dhe fuqi materiale, sepse nuk ka forcën shpirtërore e cila do ta ruante.

Dhe, a nuk kapituloi sunduesi Bizantin vetëm disa vjet më vonë pranë shpatës së Halid ibn Velidit në luftën te Jermuku, derisa ushtria prej një milion luftëtarësh u shpërnda në kohë prej 24 orësh si pluhur i shkapërderdhur nga era?!

Falënderimi të takon Ty, o Zot!

A ishte kjo rezultat i planifikimit siç ndodhte te Abraham Linkoln i ose Çegevara? Ose ne vërtet gjendemi pranë një Lajmëtarit madhështor nga Zoti, i cili vepron me forcën, vullnetin dhe përmbajtjen e të Gjithfuqishmit, në pajtueshmëri me forcën njerëzore, besimin dhe vendosmërinë. Këtu shtrihet shpirti i madh i fshehur në zemrat e këtyre beduinëve, i cili i vë në lëvizje para vetes si rrëmujë. Mbërrin me ta në Kajrevan, Andaluzi, në bregun e Atlantikut nga ana perëndimore gjer te bregu i detit Persik në anën lindore dhe gjer te Dardanelet në veri, duke mos sjellur shkatërrimin dhe tmerrin në vendet e zaptuara, ashtu siç bënin Mongolët dhe Tatarët, por Kur'anin, civilizimin, dritën, paqen, dashurinë dhe të mirën.

Nuk e thotë të vërtetën ai që pohon se Islami është përhapur me fuqi. Çfarë dobie bënë shpatat, topat, pushkët dhe mitralozët e Italjanëve në Libi? E gjithë kjo nuk shtyu asnjë musliman ta braktisë Islamin. As ushtria e madhe franceze dhe armatimi më modern nuk u ndihmuan që ta imponojnë fenë e tyre në Tunis, Maroko ose Algjeri. Islami vazhdoi të mbijetojë aty ku e la Ukbe ibn Nafi para më se një mijë vjetësh. Këtu pra, bëhet fjalë për Profetësi, ndërsa nga ana tjetër bëhet fjalë për madhështi kaluese, e cila ndërton famë që i ngjan kullave nga rëra e detit. Më në fund kullat rrëzohen nga vala më e vogël.

Kullat zhduken, ndërsa ajo që u bën dobi njerëzve mbetet mbi tokë.

## THYERJA E MARRËVESHJES

Kurejshët e thyen marrëveshjen e Hudejbijes në momentin kur e vranë një anëtar të fisit Huza, i cili e kishte pranuar Islamin që më parë. Vrasja që e nxitur nga Ikrime ibn Ebu Xhehli. Përfaqësuesi i fisit Huza, Amër ibn Salim shkoi në Medinë dhe kërkoi ndihmë nga i Dërguari ﷺ duke i treguar se ç'ka ndodhur. I Dërguari ﷺ e pa se nuk ka tjetër rrugëdalje, pos sulmit ndaj Mekkës. Ebu Sufjani u frikësua nga kjo që ndodhi dhe shkoi në Medinë që ta qetësojë gjendjen dhe ta ruajë paqen. Atje u përpoq të gjejë të Dërguarin ﷺ. Kur hyri në dhomën e vajzës së vet (Ummi Habibe), ajo largoi shtratin pranë tij që të mos ulej në të. Kur vëreu këtë, Ebu Sufjani pyeti:

-A e hoqe se e do më tepër babain nga shtrati, ose më tepër shtratin nga babai?!

Ajo u përgjegj:

-Ai është shtrati i të Dërguarit të Zotit, ndërsa ti je idhujtar i papastër, prandaj unë nuk desha të ulesh në të!

Ebu Sufjani u mërrol dhe ia ktheu me hidhërim:

-Për Zotin, moj bijë, pas meje do të kesh telashe.

Ebu Sufjani nuk mundi të gjejë askë nga muslimanët që do t'i ndihmonte. U kthye në Mekë. Të gjitha shpresat humbën. Ndjeu se Muhammedi ﷺ kishte për qëllim diçka që do të rezultonte pushtimin e Mekës.

I Dërguari ﷺ përgatiti një ushtri prej 10.000 ushtarësh. Ai mbërriu deri te vendi Mer ez-Zehran.

Në këtë kohë Kurejshët ishin fundosur në polemikë të thellë, duke u zënë se çfarë të bëjnë që me sukses ta mundin Muhammedin ﷺ. Ebu Sufjani doli të takohet me Muhammedin ﷺ dhe me vete mori si përcjellës Abbas ibn Abdul-Muttalibin. Të Dërguarin ﷺ e takoi në vendin Mik el-Ukba dhe aty i penduar pranoi Islamit.

Ushtria u nis për në Mekë. Ebu Sufjani e përcolli kolonën marshuese duke ndenjtur në el-Xhebel (ngushtica e kodrinës që gjendet në hyrje të Mekës). Pranë tij kalonin çetat muslimane, me mijëra ushtarë. Më së tepërmi përshtypje linte “Çeta e gjelbër”, e përbërë nga muhaxhirët dhe ensarët, e cila gjendej rreth Muhammedit ﷺ, pjestarët e së cilës ishin të veshur me mburoja hekuri. Prej tyre mundeshin të vërehen vetëm shiqime të rrepta.

Kur iu bë krejt e qartë, Ebu Sufjani i pëshpëriti përcjellësit të vet:

-Për Zotin, Abbas, askush nuk ka forcë të tillë... Për Zotin, kushëriri yt do të ketë një ardhmëri të shkëlqyeshme...

## HYRJA MADHËSHTORE NË MEKKË

Gjatë hyrjes në Mekkë, Bilali thërriste:

-Kurejshë, kush do të strehohet në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurtë. Kush do të tërhiqet në shtëpinë e vet, do të jetë i sigurtë, dhe kush do të tërhiqet në Kabe gjithashtu do të jetë i sigurtë!

Muhammedi ﷺ hyri në Mekkë i rrethuar me kalorësinë dhe armët, i hipur në deven e tij, krenar dhe modest ndaj Zotit të vet... Kur u tubuan, u thërriti armiqtëve të tij, atyre që e gurëzonin, mundonin dhe që ia vritnin ithtarët:

-Kurejshë, ç'mendoni, ç'do të bëj me ju?

-Diçka të mirë, o vëlla fisnik, bir i vëllait fisnik, -u përgjigjën, por frika nuk i lëshonte...

-Shkoni, jeni të lirë! -u përgjigj Muhammedi ﷺ.

Ja pra, ky është Lajmëtari, qoftë paqja mbi të.

# MUHAMMEDI ﷺ

## -FISNIKËRUES I NJERËZVE PAMJA DHE VETITË SHPIRTËRORE

Sipas të dhënave që i hasim në veprat biografike mbi Muhammedin ﷺ, ai përshkruhet si njeri me lartësi mesatare, me fytyrë të rrumbullakët dhe ngjyrë lëkure të çelur por jo të bardhë, e as shumë të mbyllur; sy të mëdhenj dhe të zinj; qerpikë të gjatë; dhëmbë të pastër dhe të bukur; mjekër të shpeshtë me disa fije të bardha përfundi buzës. Vetullat i ka pasur pak të bashkuara me një xhungë në mes; ka qenë shpatullgjerë me pëllëmbë dhe shputa të mëdha. Flokët i ka pasur gjysmë dredha, të cilat gjatë muajit të Haxhxhit i rruante dhe pastaj i lëshonte gjer te të butit e veshëve, ndërsa në tëmblat ka pasur disa fije të bardha. Era e dorës së tij të butë ka qenë më e këndshme se moshusi.<sup>liv</sup> Kur ka hecur, trupin e ka hedhur nga pak përpara, hapat i ka pasur të vendosura, ndërsa shiqimin e ka rrëzuar përtoke.

Shpesh mendonte dhe heshtte. Kur fliste, fliste gojëhapur (jo tinëzisht), rrjedhshëm dhe me kuptim të thellë, të përshtatshëm për njeriun mesatar. Kishte sjellje të butë, jo të rreptë, e as të mllefosur gjatë të folurit. Po ta thirrte dikush do të kthehej i tëri, (jo vetëm kokën) ndërsa kur do të tregonte diçka, do ta bënte këtë me tërë pëllëmbën. Kur fliste për diçka e shtypte shuplakën e dorës së majtë me gishtin e madh të dorës së djathtë. Nuk qeshej me zë të lartë, por vetëm buzëqeshej. Asnjëherë nuk hakmirrej, pos nëse thehej ligji i Zotit. Asnjëherë nuk i ka rënë ndihmësit (shërbetorit) ose ndonjëres prej grave.<sup>lv</sup> Ka qenë dorëdhënë, e posaçërisht në muajin

Ramadan, kur i kanë ardhur më shpesh shpalljet. Kur ka qenë i gëzuar fytyra i ka shndritur si një copë hëne, ndërsa kur është hidhëruar për diçka, ajo është vërejtur qartë në fytyrën e tij.

Ka qenë i bukur dhe i turpshëm, ndërsa në raste kur nevojitej trimëria, më i guximshmi dhe më i fuqishmi. Ka qenë më i bukur në fytyrë dhe në pamje. Ushqimit nuk i ka gjetur të meta; nëse i ka pëlqyer e ka ngrënë, e nëse jo, e ka lënë.

Aishja ﷺ, gruaja e tij thotë:

“I dërguari ﷺ asnjëherë nuk është ngopur me ushqim. Shumicën e ditëve i ka kaluar në agjërim. Kur (kah fundi i jetës së tij) i thashë se do ta kisha dhënë jetën për të, nëse do të mund të gjeja diçka që do ta forconte (nga sëmundja), ai më tha:

-Aishe, unë në këtë botë nuk kam shokë më të mirë sesa të dërguarit tjerë të Zotit, të cilët kanë duruar mundime shumë më të mëdha se këto, por e kanë vazhduar thirrjen (në Islam) në atë gjendje, kanë lutur Zotin e tyre, ndërsa Ai ua ka dhuruar mbrojtjen e Tij dhe i ka shpërblyer me shpërblime të mëdha. Për këtë shkak, ndjej se do të isha turpëruar nëse jetoj në kënaqësi, e nesër ngel pa to. Për mua nuk do të ketë gëzim më të madh sesa takimi me vëllezërit dhe shokët e mi.”

Megjithkëtë, ai nuk refuzonte ushqimin që e pëlqente ose teshën e bukur që i ofrohej. Por asnjëherë nuk i nënshtrohej dëshirës për jetë të këndshme. Madje as nuk lodhej të mendojë për këtë. Për këtë shkak jetonte duke u ushtruar në modesti; ndërsa dëshirave u qasej me urtësi dhe maturi, që të bëhej shembull i asaj që kërkon Islami, religjioni i maturisë dhe mesatares.

Kjo është liria e vërtetë! Liria kur njeriu çlirohet nga dëshirat dhe nuk i lejon këndjes që ta mundë.

Ky mes, kjo rrugë e drejtë dhe e vështirë është më e hollë se një qime e vendosur mes të tepruarit dhe mosinteresimit. Kjo është ajo në çka dretësia Islame është unike, të cilën i Dërguari ﷺ e ka realizuar me sjelljen e tij shembullore dhe të pakrahasueshme.

Ky njeri gjithmonë ishte i thjeshtë dhe modest. Ke mundur ta shohësh si lan teshat e veta në shtëpi, si i arnon ato, si i mjel delet ose si i qep këpucët. Ke mundur ta shohësh edhe duke ngrënë me shërbëtorët shtëpiakë, duke i vizituar të sëmurët dhe duke u dhënë të varfërve dhe të devotshmëve.

I donte pamasë njerëzit, kafshët, e madje edhe bimët. Porosiste që trungjet të mos priten. Dashuria e tij përfshinte edhe lëndët jo të gjalla. Për kodrën e Uhudit thoshte:

“Kjo kodër na do dhe ne e duam!”

Në biografitë e shkruara mbi jetën e Muhammedit ﷺ theksohet se plagosja e tij në kokë dhe thyerja e dhëmbit në luftën e Uhudit i mallëngjeu shumë as’habët, saqë dikush prej tyre tha:

-Sikur t’i kishe mallkuar! Ndërsa ai ia ktheu:

-Unë nuk jam i dërguar të mallkoj, por jam i dërguar si mëshirë! O Zot, udhëzoje popullin tim se ai nuk di!

Kur Zejd ibn Se’ama ia kërkoi të Dërguarit ﷺ borxhin, e tërhoqi për teshe dhe i tha:

-Ju Abdimenafët zvarriteni!

Umeri e shtyu, ndërsa i Dërguari ﷺ u buzëqesh dhe tha:

-Unë dhe ai, Umer, nuk kishim nevojë për këtë mosmarrëveshje. Urdhëroje që të sillet mirë, ndërsa mua urdhëromë që t'ia paguaj borxhin! dhe shtoi: -Për këtë çështje Zejdi priti 3 ditë!

Umeri urdhëroi që t'i paguhet kërkesa dhe që t'i ipet edhe diçka më tepër, për shkak të frikës që e kishte përjetuar Zejdi (ngase mendoi se nuk do t'i kthehen paratë). Ky ishte edhe shkakun që Zejdi ibn Se'ama pranoi Islamit.

Rrëfimet mbi butësinë, mëshirën dhe dashurinë e Lajmëtarit ﷺ nuk kanë fund. Ky njeri fisnik, thonë as'habët, gjithmonë ka dhënë me dëshirë, sikur asnjëherë të mos i frikësohej varfërisë. Nuk ka ndodhur që të ruajë as një monedhë të vetme. Kur ka ndërruar jetë, këmisha mbrojtëse e tij ka ngelur si peng te një jahudi.

Për thelbin e drejtimit të vet jetësor thoshte:

-Njohja (e Zotit) është pasuria ime, arsyeja është baza e fesë sime, dashuria drejtimi im, dëshira e fortë është anija ime, përmendja e Zotit është përcjellësi im i pandërprerë, mallëngjimi është shoku im, durimi është mbështjellësi im, sigureteti është mbrojtësi im, dijenia është arma ime, lufta në rrugën e Zotit morali im, ndërsa ngushëllimi im është në namaz.

Ky ishte Muhammedi ﷺ, Lajmëtar i pashkolluar, i cili i tejkaloi të gjithë ata që lexojnë dhe shkruajnë. Ky është ai njeri i ndershëm për të cilin Zoti thotë:

“Ti vërtet je në një shkallë të lartë morali!”<sup>lvi</sup>

Shokut të tij të ngushtë, Ebu Bekrit ia përshkroi moralin e vet në këtë mënyrë:

“Mua më ka edukuar Zoti im, po sa bukur më ka edukuar!”

Shtëpia e të Dërguarit ﷺ në Medinë ishte e ndërtuar nga degët e palmave të ngjitura me baltë. Disa dhoma kanë qenë të ndërtuara nga gurët, por që të gjitha kanë qenë të mbuluara me gjethe palmash, ndërsa krevati i tij përbëhej nga dërrasat e drurit të lidhura me berk, mbi të cilin gjendej edhe mbulesa nga berku.

Dashurinë e tij të sinqertë ndaj ithtarëve të tij e vërejmë edhe në bisedën mes tij dhe një as'habi të ri - Muadh es-Sulmit, i cili ishte 14 vjeçar në rastin e kësaj ndodhie. Muadhi kështu e tregon këtë ndodhi:

“Shkova një ditë te i Dërguari dhe i thash:

-O i Dërguar i Zotit, dëshiroj të vij me ty në luftë, që ta fitoj kënaqësinë e Zotit dhe ta fitoj amshueshmërinë (ahiretin). Ai më pyeti:

-A e ke të gjallë nënën?

-Po -i thash.

-Kthehu dhe kujdesu mirë për të -më tha.

Atëherë unë kalova në anën tjetër, e pak më vonë u ndala pranë tij, ndërsa ai më tha:

-Mjerë për ty... Ktheju nënës tënde! Xhenneti fitohet duke i shërbyer nënës!” ...

Ebu Umame tregon se dikush paska pyetur:

-O i dërguar i Zotit, çfarë janë të drejtat e prindërve ndaj fëmijëve? Ndërsa ai është përgjegjur:

-Ata janë Xhenneti dhe Xhehennemi i tyre.

Ky është ai Lajmëtar i Zotit, i cili ndonjëherë e merrte nipin e tij në krah dhe shkonte për t'u falur. Ndodhte që nipi i hipte mbi shpinë gjatë sexhdes<sup>lvii</sup>, dhe ai duke mos dashur ta shqetësojë nipin e vogël, i cili rrëshqiste në shpinën e tij, zhgjaste sexhden. Ishte thjesht një mishërim i butësisë dhe dashurisë për çdo gjallesë.

Kur fliste i Dërguari ﷺ, nuk fliste nga dëshira dhe pa qëllim, por fliste me një urtësi të posaçme. Xhahidhi të folurit e tij e përshkruante kështu:

“...Të folurit e tij karakterizohej me pak fjalë, por shumë kuptime, bukur i shprehur dhe pa shprehje të rënda. Ai merrte për argument vetëm të vërtetën. Nuk do të përpiqej të shërbehet me shprehje fascinate, e as nuk përdorte fjalë me kuptime të kundërta. Nuk fliste me sarkazëm e as nuk fliste për diçka të keqe. Nuk shpejtonte, e as nuk zvarritej gjatë të folurit. Nuk i ipte shkak armikut që ta kundërshtojë, ndërsa oratori nuk merrte guxim t'i kundërvihet. Njerëzit nuk kishin dëgjuar fjalim më të përmbledhur dhe adekuat për ta shprehur një tërësi kuptimore, të përshtatur vendit dhe kohës, ndonjë të folur më të lehtë, që do të kishte kuptim më të thukët, ose ndonjë të folur që kishte kuptim më të qartë sesa të folurit e Lajmëtarit ﷺ...”

Shumë mendime të Lajmëtarit ﷺ kanë marrë karakteristikë të fjalëve të urta, si shembull:

-Asnjëherë nuk shkatërrohet njeriu pas konsultimit.

-Besimi nuk është në dëshirë, por në zemër dhe në vërtetimin e tij me vepër.

-Shumë njerëz nuk arrijnë t'i çmojnë dy begati: shëndetin dhe kohën...

- Besimtari nuk guxon të lejojë që ta kafshojë gjarpëri dy herë nga vrima e njëjtë.
- Veprat vlerësohen sipas qëllimit, dhe çdokush do të vlerësohet sipas asaj që ka pasur për qëllim.
- Askush asnjëherë nuk ka ngrënë diçka më të mirë sesa kafshatën që e ka fituar me dorën e vetë.
- Nuk është i fortë ai që është i fuqishëm, por i fortë është ai që frenon veten kur është i mlllefosur.
- Dora e lartme është më e mirë se dora e poshtme (më i mirë është ai që jep sesa ai që merr).

I Dërguari ﷺ na mësoi lehtësimin dhe kënaqësinë, por gjithashtu na mësoi edhe si të jemi të matur në çdo gjë.

Shokët e tij që i dërgonte si ambasadorë nëpër vende të ndryshme për t'ua mësuar njerëzve rregullat Islame i këshillonte në këtë mënyrë:

“-Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos largoni, (mos i shpërndani njerëzit me fjalë të pazgjedhura) bëjuni të drejtë dhe përmbajuni mesatares! Afrohuni njëri tjetrit!

-Kjo fe është e fortë, pra dorëzohuni butë punës intenzive në të. Mos ia vështërsoni vetes adhurimin e All-llahut, sepse ai që e tepron as nuk ia arrin qëllimit, por edhe shpina nuk i ngel e shëndoshë.”

Specifiteti i Islamit është që të mos e shohë të mirën ideale në jetën nëpër teqe dhe manastire, e as në format e thjeshta të realitetit, por në pastrimin e realitetit aq sa ai mund të pastrohet, si dhe me vënien e një ure mes njeriut dhe jetës ideale, me qëllim që njeriu të ngrehet në shkallën e jetës

ideale hap pas hapi, duke mos e ngarkuar natyrën e tij të paqëndrueshme. Të mos ishte kjo butësi në bartjen e detyrave dhe ky ushtrim gradual i shpirtit, ideali do të ngelej në yjësinë e vet si ngjyra në letër, ndërsa njeriu do të humbej nën thundrat e materies ashtu siç humbet uji në rërë.

Ajshja ﷺ, gruaja e tij thotë:

“I dërguari i Zotit asnjëherë nuk hakmirrej për veten, por hakmirrej vetëm kur thehej Ligji i Zotit... Kur kishte mundësi të zgjedhë ndërmjet dy gjërave, e zgjidhte më të lehtë, nëse nuk ishte e ndaluar.”

Gjithashtu, në një hadith tjetër përmendet:

“Shtatë njerëz All-llahu do t’i marrë nën hijen e vet Ditën kur nuk do të ketë hije tjetër, pos hijes së Tij:

-sundimtarin e drejtë;

-të riun i cili e ka kaluar rininë duke adhuruar Zotin;

-njeriun i cili e ka zemrën e lidhur për xhaminë;

-dy njerëz të cilët janë dashur për hir të All-llahut, të cilët takoheshin dhe ndaheshin vetëm për hir të All-llahut;

-njeriun të cilin e ka thirrur grua e famshme dhe e bukur, ndërsa ai e ka refuzuar duke thënë: “Unë i frikesohem All-llahut!”;

-njeriun i cili kur e ka dhënë lëmoshën as dora e majtë nuk e ka ditur se ç’jep e djathta dhe  
-njeriun i cili kur në vetmi përmend All-llahun i rrjedhin lotët...”

Fjalët e tija të bukura janë edhe këto:

Dora e All-llahut është me xhematin, sepse ujku e sulmon tufën e shpërndarë”;

Xhenneti është i rrethuar me vështirësi, ndërsa Xhehennemi me kënaqësi.”

Asnjë prej jush nuk beson, derisa t’ia dojë vëllait atë që ia do vetes.”

Zoti i shkatërroi ata para jush, të cilët nuk e dënonin të famshmin kur ai vidhte (shumë) ndërsa e dënonin të dobëtin kur vidhte (pak).”

Një ditë u tha as’habëve ﷺ:

A e dini se kush do të jetë “muflis” në ditën e gjykimit?

As’habët thanë: -Ne e quajmë “muflis” atë që nuk ka asnjë para, e as nuk ka diçka për të shitur. I Dërguari ﷺ tha:

Muflis në ditën e Gjykimit do të jetë ai që ka sharë filanin dhe filanin, ka rrahur filanin dhe filanin, ka ngrënë pasurinë e filanit dhe filanit; dhe ka derdhur gjakun e filanit dhe filanit. Ky njeri në ditën e Gjykimit do t’u shpaguhet atyre (që i ka dëmtuar) me veprat e mira që i ka bërë, ndërsa kur ato do të shpenzohen, atij do t’i ngarkohen mëkatet e tyre dhe pastaj do të hidhet në zjarr!

Muslimi<sup>lviii</sup> transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë:

“Besimtari i fuqishëm (fizikisht) te Zoti është më i dashur sesa besimtari i dobët, edhe pse në të dy ka dobi.”

Në thëniet e të Dërguarit ﷺ për vlerën e forcës gjejmë vërtetim se Islami është energji (dinamikë) e jo plogësi, vyshkje ose dështim.

Me një rast një njeri i kërkoi këshillë të shkurtë, ndërsa ai i tha:

-Mos u zemëro!

Njeriu e pyeti tri herë, e ai përgjigjej shkurt dhe pa shtim:

Mos u zemëro!

Gjithashtu transmetohet se ai ka thënë:

“Mendoni për krijesat, e jo për Krijuesin, sepse truri njerëzor nuk mund ta njohë Zotin (në cilësitë e Tij përkatëse).”

## **A THUA AI SHKROI KUR’ANIN?**

Kur kritiku letrar me shije të sprehur e dëgjon hadithin (fjalën e të Dërguarit ﷺ) dhe e krahason atë me Kur’anin, ndjen se çdonjë prej tyre rrjedh nga dy burime të ndryshme dhe se do të kishte qenë e pamundur që autori i hadithit të jetë njëkohësisht edhe autor i Kur’anit.

Në lidhje me këtë dijetari Dibag në veprën e tij “El-Ibriz” thotë:

“Çdokush që dëgjon Kur’anin dhe e njohton në thellësi domethënien e tij, pa dyshim do ta kuptojë se Kur’ani është të folurit e Zotit, ndërsa madhështia që gjendet në të dhe autoriteti që ndërtohet brenda tij reflekton Lartmadhërinë dhe Autoritetin e Zotit.”

“Lexo në emër të Zotit tënd, i Cili krijoi!”<sup>lix</sup>

Ky ajet nga Kur’ani depërton në zemrën e njeriut duke ia bërë me dije se ligjëron më i Larti (All-llahu), i Cili ka autoritetin e vet të pacenueshëm në fuqinë dhe madhësitinë e fjalëve të Tij.

“Lexo në emër të Zotit tënd, i Cili krijoi!

Krijoi njeriun nga rrecka;

Lexo, për Zotin tënd Bujar,

I Cili (ju) mësoi pendën

Mësoi njeriun atë që nuk dinte!”<sup>lx</sup>

“Dhe qe thënë:

Oj tokë, thithe ujin tënd, ndërsa ti o qiell ndërprej (shiun)! Dhe kështu uji u tërhoq dhe urdhëri u përmbush...”<sup>lxi</sup>

Kush është Ai që jep këso urdhërash kozmike, të cilave edhe Gjithësia u nënshtrohet?

Çdo fjalë e Tij është urdhër madhështor dhe i veçantë!

Shihet qartë se autoriteti dhe fuqia e këtyre fjalëve munden të rrjedhin vetëm nga autoriteti dhe fuqia e Pronarit të tyre. Këtu qëndron dallimi esencial mes stilit të Kur'anit dhe stilit të hadithit!

Ekzistojnë edhe shumë lloje tjera të dallimeve mes stilit të Kur'anit dhe stilit të hadithit, për çka kam folur më gjerësisht në librin “Dialog me mikun ateist” në kapitullin “Përse të mos jetë Kur’ani vepër e Muhammedit ﷺ?” Pra, nëse dikush dëshiron më tepër sqarime në lidhje me këtë çështje, le t’i hedhë një vështrim këtij libri.

Është ashiqare se të kuptuarit e vërtet të Kur'anit ka ndryshuar shumë, kur bëhet krahasim mes kohës kur është shpallur dhe kohës së sotme. Kur beduini do ta dëgjonte dikë duke lexuar Kur’an, do ta ndjente se të lexuarit ia kaplon krahërorin. Do ta detyronte deven që të përulet, do të zbriste nga ajo dhe do të deklaronte:

“Nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut!” dhe do t’i dorëzohej All-llahut me tërë qenien e vet. Mbinatyrshtëria e stilit të Kur'anit për këtë njeri me natyrë të pastër paraqiste diçka të shenjtë, e cila nuk ka rival.

Megjithatë, sot njeriu ka humbur mjaft prej aftësisë intelektuale dhe besnikërisë së vjetër ndaj filozofisë; veshët i janë shurdhuar, zemra i është shtangur ndaj ndjenjave, ashtu që sot atij i duhen argumente. Një ndër shkaktarët për këtë ka qenë edhe distanca prej një mijë e katërqind vjetëve, largimi nga burimet filozofike, si dhe mosnjohja e themeleve të diturive gjuhësore.

## SHTETI I RI

Pas çlirimit të Mekkës, Ebu Bekri u nis që ta kryejë Haxhxhin së bashku me treqind muslimanë të tjerë. Gjatë kësaj ceremonie, idhujtarët qenë përzier në rreshtat e muslimanëve duke krijuar çrregullime në ta. Atëherë u shpallën ajetet nga sureja “Tewbe”, të cilat Aliu ﷺ i citoi duke qëndruar para të tubuarve:

“O ju që besuat, vërtet idhujtarët janë të ndytë, prandaj pas këtij viti le të mos i afrohen xhamisë së shenjtë. Nëse i frikësoheni skamjes, (dijeni se) All-llahu me dëshirën e vet do t’ju pasurojë me mirësitë e Tij. All-llahu është i Gjithdijshëm, i Urtë.”<sup>lxii</sup>

Zoti mbajti fjalën dhe i shpërbleu muslimanët me atë që shndërroi Hixhazin në një ndër vendet më të pasura në botë.

Atë ditë Aliu ﷺ me zë të lartë ua përcolli njerëzve urdhërat e Zotit dhe të Lajmëtarit të Tij:

“Njerëz! Pabesimtari nuk hyn në Xhennet, ndërsa pas këtij viti idhujtari nuk guxon të shëtisë nëpër këtë vend të shenjtë i zhveshur, ndërsa nëse dikush ka lidhur marrëveshje me Muhammedin ﷺ, marrëveshja mbetet në fuqi derisa asaj t’i kalojë afati!”

Prej atëherë idhujtarët nuk qarkonin reth Kabes të zhveshur siç e bënin këtë më parë. Me këtë ligj u vu edhe themeli i parë i shtetit Islamik.

All-llahu e dinte se ky shtet i posaformuar do të ballafaqohet me shtetet më të fuqishme kundërshtare- Bizantin dhe Persinë, se do t'i kërcënohet rreziku nga çdo anë. Ai e dinte se lufta do t'u imponohet dhe se do të duhej ta pranojnë si rrugëdalje të vetme, prandaj u urdhëroi:

“Luftoni idhujtarët pa përjashtim, siç luftojnë ata të gjithë kundër jush, dhe ta dini se All-llahu është me ata që i frikësohen.”<sup>lxiii</sup>

## ÇASTET E FUNDIT TË JETËS NË KËTË BOTË

Më 25 Dhul-kade, dhjetë vjet pas Hixhrës i Dërguari ﷺ shkoi në Mekkë që ta kryejë Haxhxin Përfundimtar (Haxhxin e lamtumirës), duke u përcjellur nga mijëra besimtarë...

I Dërguari ﷺ qëndroi në bregun Arafat dhe ligjëroi Hutben e fundit<sup>lxiv</sup>:

“Njerëz, më dëgjoni mirë, sepse nuk e di a do të takohem me ju përsëri pas këtij viti në këtë vend!

Njerëz, gjaku juaj dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend!

Çdo lloj i kamatës është i ndaluar.

Kamata e Abasit, birit të Abdul-Mutalibit është e këputur.

Çdo gjakmarrje nga periudha paraislamike është e këputur...

...O njerëz, kuptoni fjalët e mia! Ua kam lënë Librin e Zotit dhe sunnetin e të Dërguarit të Tij, dhe nëse u përmbaheni, nuk do të lajthitni kurrë!...

...Muslimanët janë vëllezër. Njeriut i është lejuar vetëm ajo që tjetri ia jep vullnetarisht, pra mos i bëni vetes padrejtësi!

O Zot, dëshmo!”

Dhe në atë moment madhështor iu shpall ky ajet:

“Sot ua kam përsosur fenë tuaj, plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe jam i kënaqur që Islami të jetë fe e juaj!”<sup>lxv</sup>

Ebu Bekri filloi të qajë. Ndjeu se jeta e të Dërguarit ﷺ i është afruar fundit.

I Dërguari ﷺ u kthye në Medinë.

Atje sëmundja e lidhi për shtrati... Nxehtësia e trupit i shtohet... Ndonjëherë heshtte e ndonjëherë psherëtinte, e më vonë tha:

“Zoti i dha njeriut zgjedhje mes kësaj bote ose botës tjetër, e ky zgjodhi atë që është te Zoti.”

Përsëri heshti. Njerëzit u çuditën, nuk e kuptonin. Vetëm Ebu Bekri qau, sepse kuptoi domethënien e këtyre fjalëve: I Dërguari ﷺ këto fjalë i tha për veten: se Zoti i ka dhënë zgjedhje mes dunjasë dhe ahiretit dhe ai e ka zgjedhur mikëpritjen e Zotit.

Atëherë urdhëroi që të marrin ujë dhe të lahet, e pastaj iu ul pak nxehtësia. Hyri në xhami për t'u falur. Pas faljes i Dërguari ﷺ e pa Ebu Bekrin me butësi dhe mallëngjim dhe urdhëroi që të mbyllen të gjitha dyert që çonin në xhami pos dyerve të Ebu Bekrit dhe tha:

“Nuk e di se kush ka qenë më i mirë se ai (Ebu Bekri) në shoqërim. Nëse do ta merrja dikë prej njerëzve për shok, do ta merrja Ebu Bekrin... Por ky shoqërim do të ishte vetëm shoqërim në fe dhe në vëllazëri...”

Pastaj filloi përsëri t'i rritet nxehtësia, ashtuqë ishte i detyruar të kthehet në shtëpi. I urdhëroi Ebu Bekrit ta udhëheqë faljen. Më vonë u alivanos nga nxehtësia e madhe, por u përmbloodh duke u ngërçuar nga dhembjet e mëdha. Filloi ta lagë dorën me ujin e ftohtë që gjendej në enën pranë tij. Fshiu fytyrën me të. Fatimja, e cila ishte afër tij i pëshpëriti:

“Baba, babai im!”; Ndërsa ai ia ktheu me mallëngjim:

“Prej sot babai yt nuk do të ketë më brenga...”

Para fundit të jetës i Dërguari ﷺ kishte 7 dinarë, për për të cilët urdhëroi që të shpërndahen si lëmoshë, duke thënë:

“...Ne Lajmëtarët as nuk lëmë pas vetes pasuri, e as nuk mund të trashëgohem... Çdo gjë që lëmë është lëmoshë.”

Mëngjesin tjetër i Dërguari ﷺ me mundim u çua për t'u falur në xhami. U mbështet në Aliun ﷺ dhe në ibn Abasin ﷺ. Kur mbërrinë, aty më kishte filluar namazi. U ul në anën e djathtë të Ebu Bekrit dhe u fal i ulur. Pas kryerjes së namazit tha:

“Njerëz, nëse i kam rënë dikujt, ja ku e kam kurrizin, le të hakmerret... Nëse dikujt i kam borxh, ja ku e kam mallin tim, le ta marrë pjesën e vetë.”

Në momentet e fundit të jetës tha:

“O Zot, më bashko me ata që kanë pasur mirësinë Tënde prej Lajmëtarëve, prej njerëzve të drejtë, dëshmorëve dhe njerëzve të mirë. O Zot, mi fal të metat, kij mëshirë ndaj meje dhe më bashko me shokun më të Lartë!”

...dhe ndërroi jetë.

## REAGIMET E MUSLIMANËVE

Ebu Bekri shpejt shkoi në shtëpinë e Aishes رضي الله عنها. Kur kërkoi leje për të hyrë brenda, ajo tha:

“Sot nuk ka nevojë për të kërkuar leje për hyrje”

Kur hyri, e gjeti të Lajmëtarin رضي الله عنه të shtrirë në shtratin e vdekjes, të mbuluar me pëlhurë. Ju afrua, ia zbuloi fytyrën dhe tha:

“Sa i bukur je, i gjallë dhe i vdekur!...”

Ia vendosi kokën mbi jastëk dhe ia mbuloi fytyrën me mbulesë.

Kur doli jashtë, pa se njerëzit po ziheshin mes vete se a ka ndërruar jetë Muhammedi ﷺ apo jo. Në krye të kësaj grupe ishte Umeri ؓ i cili i kërcënohej çdokujt që do të thoshte se Muhammedi ﷺ ka ndërruar jetë.

Ebu Bekri qëndroi mes tyre dhe tha me zë të qetë:

“Njerëz, kush e ka adhuruar Muhammedin, le ta dijë se Muhammedi vdiq. Por kush e ka adhuruar All-llahun, le ta dijë se All-llahu është i Gjallë dhe nuk vdesë...” dhe citoi:

“Muhammedi nuk është tjetër, pos i Dërguar. Edhe para tij ka pasur të dërguar. Sikur të vdiste ai apo të vritej, a do të ktheheshit gjurmëve të juaja? Kush kthehet gjurmëve të veta nuk i bën dëm All-llahut dot, ndërsa All-llahu do t’i shpërblejë mirënjohësit.”<sup>lxvi</sup>

Kur Ummeri ؓ dëgjoji Ebu Bekrin si e citon këtë ajet nga Kur’ani, ra në gjunj sikur t’i ishin prerë këmbët duke kuptuar se i Dërguari ﷺ vërtet ka ndërruar jetë...

Pastaj, kur Ebu Bekrin e zgjodhën për udhëheqës, ai u çua dhe tha:

“Njerëz, pranova udhëheqjen ndaj jush, edhe pse mundet nuk jam më i miri mes jush. Nëse ju udhëheq mirë, më përkrani, por nëse gaboj, më drejtoni... Nënshtrohuni në atë që edhe unë i nënshtrohem Zotit dhe të Dërguarit të Tij, por nëse unë gaboj ndaj Zotit dhe të Dërguarit të Tij, unë nuk kam të drejtë t’ju kërkoj që të më nënshtroheni. Faleni namazin, do t’ju mëshirohet All-llahu...”

Çfarë dallimi të madh ka mes këtyre fjalëve dhe fjalëve tiranike të halifit el-Mensur Abasit, të cilat i shqiptoi në vendin e njëjtë rreth dy shekuj më pas:

“Njerëz, unë jam sulltani i Zotit në tokën e Tij, ruajtës i pronës së Tij dhe punoj sipas dëshirës së Tij. Zoti më bëri dry të kësaj prone. Nëse Ai do të dëshirojë që të çilem, do të çilem që t’ju jap, e nëse do të dëshirojë që të më mbyllë, do të mbyllem.”

Ky ishte një apsolutist, i cili erdhi në pushtet që të sundojë me sundim të pakufizuar, duke e thirrur në ndihmë edhe të drejtën e shenjtë, njëlloj si sunduesit e “periudhës së errët” në Evropë, të cilët kërkonin ndihmë nga Papa për t’i realizuar qëllimet e veta apsolutiste...

Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është rob, i dërguar dhe lajmëtar i fundit i Zotit. Më mjafton edhe kaq nga jeta që atij ia dhuroi All-llahu.

Shpresoj se do ta pasoj ligjin që na e transmetoi, se do të thërras në atë që ka thirrur ai, se në ditën e Tubimit do të ringjalle nën falmurin e tij dhe se do të jem ndërmjet atyre që ishin të vendosur në thirrjen e tij.

Le të jetë bekimi dhe shpëtimi i Zotit mbi Lajmëtarin tonë për të gjitha kohërat.

Lavd-falënderimi i takon All-llahut ﷻ që na e mundësoi këtë.

---

i ﷻ - 'Alejhis-selam: Paqja qoftë mbi të.

ii ﷻ - Subhanehu we te'ala: I Madhëruar (i pa të meta) dhe i Lartësuar.

iii Kurejsh - fis arab, të cilit i takonte Muhammedi ﷺ

- 
- iv Nata e Israsë- Muhammedi ﷺ brenda natës udhëtoi në xhaminë “Mesxhidul-Aksa” në Jerusalem, e prej aty në sferat e larta qiellore.
- v Kehf ;110
- vi Fjala profetësi në këtë libër është përdorur në kuptim të fjalës arabe “nubuwet”, e cila në përkthim tekstual do të thotë lajmëtar
- vii Transcendentale-jashtë mundësive të të hetuarit të shqisave
- viii Evlija- mik (i All-llahut ﷻ); njeri shumë i mirë dhe i devotshëm
- ix “Dhe ai (Muhammedi) nuk flet nga mendja e tij” (Nexhm-3)
- x Bekare; 2
- xi Nisa; 136
- xii Introdiktë-hyrje, afrim
- xiii Metafizikë- jashtë ligjeve të natyrës, realitet tjetër
- xiv Lati dhe Uzai - dy idhuj, të cilëve u luteshin arabët në kohën e injorancës
- xv Bëhet fjalë për Zotin e Lartëmadhëruar
- xvi Halidi atëherë akoma nuk e kishte pranuar Islam
- xvii kjo shprehje arabe ka kuptim: Do të dështojnë shpejt!
- xviii Ensarët (medinasit) ishin mikëpritësit e muhaxhirëve
- xix Muhaxhirët ishin të gjithë ata që migruan nga Mekka, për shkak të torturave të mëdha që ushtroheshin mbi ta
- xx Tuhama - vend në jug të gadishullit Arabik
- xxi Muhammedit ﷺ i erdhi rëndë kur i dëgjoi fjalët e ensarëve që shprehnin mosbesë ndaj tij, ndërsa ky i donte ata për së tepërmi. Madje, në një hadith nga Buhariu transmetohet se ai ka thënë:  
 “Dashuria ndaj ensarëve është shenjë e besimit, ndërsa urrejtja ndaj tyre - shenjë e dyftyrësisë.”

- 
- xxii Tewbe; 25-26
- xxiii Ali Imran; 123-126
- xxiv Enfal; 12
- xxv Enfal; 17
- xxvi Enbija; 107
- xxvii Ahzab; 56
- xxviii Epilepsi- sëmundje e rëndë kronike nervore që paraqitet me sulme të kohë pas kohëshme; pas sulmit epileptikut nuk i kujtohet se ç'i ka ndodhur.
- xxix ﷻ- radi' All-llahu 'anhu: All-llahu qoftë i kënaqur me të
- xxx Bilali ﷺ qe rob nga Abisinia (Etiopia) i cili ndër të parët pranoi Islamin. Gjithashtu ishte një ndër shokët më të ngushtë të Muhammedit ﷺ, muezini i parë, e më vonë edhe rojtar i arkës shtetërore.
- xxxi Bëhet fjalë për Muhammedin ﷺ
- xxxii Abdimenaf quhej familja e Muhammedit ﷺ
- xxxiii Ta Ha; 1-5
- xxxiv Urve qe ambasador i Kurejshëve në kohën e negociatave me Muhammedin ﷺ te Hudejbija.
- xxxv Ta Ha; 39
- xxxvi Rënia shehid në rrugën e All-llahut në Islam ka vlerë të madhe, sepse Zoti dëshmorët e Tij i shpërblen me xhennetin Firdews, i cili është më i miri nga të gjithë xhennetet.
- xxxvii Kehf; 84
- xxxviii El-Bekare; 245
- xxxix Ali-Imran; 181
- xl El-Ahzab; 10-13.

---

<sup>xli</sup> Zejnebja e kishte burrë komandantin Selam ibn Meshkemin, ndërsa baba komandantin el Harith, të cilët qenë të vrarë nga muslimanët në fushëbetejë

<sup>xlii</sup> Sipas zakonit të asaj kohe fituesi nuk e shndëronte në robëreshë vajzën e të fituarit, por e merrte për grua

<sup>xliii</sup> Aisha dhe Hafsa ishin gra të Muhammedit ﷺ

<sup>xliv</sup> Sipas ligjit Islamik shirk (përshkruarje Zotit shok) konsiderohen edhe këto vepra që mjaft shpesh hasen: falli me letra, të shikuarit në filxhanin e kafes, vënia e disa gurëve të kaltërt me qëllim të ruajtjes së shtëpisë, lidhja e nyjeve duke dashur për t'i bërë dikujt dëm, besimi në shenjat astrologjike (horoskopi), që është vetëm një formë moderne e asaj që e kanë bërë idhujtarët e mëparëshëm, lutja që u drejtohet turbeve për ta shëruar të sëmurin, madje edhe dashuria e madhe ndaj dikujt, ose diçka që të shtyn ta harrosh dhe ta lësh pas dore dashurinë ndaj All-llahut, Lajmëtarit të Tij ose fesë së Tij. Për të gjitha këto meritohet dënim i përjetshëm, sepse Zoti e falë çdo mëkat, pos shirkut.

Njerëzit që bëjnë shirk All-llahu i përshkruan në këtë mënyrë:

“...Ata që në vend të Tij (All-llahut) adhurojnë diçka tjetër, thonë:

-Ne nuk i adhurojmë këta për tjetër gjë, pos për t'iu afruar sa më tepër All-llahut...” (Zumer; 3)

<sup>xlv</sup> Shuara; 214-215

<sup>xlvi</sup> Safa dhe Merve - dy kodra afër Mekkës

<sup>xlvii</sup> Isra; 90-95.

<sup>xlviii</sup> A'raf; 188.

<sup>xlix</sup> En'am; 50.

<sup>l</sup>Ebu Talibi ishte xhaxhai i Muhammedit ﷺ

<sup>li</sup> Tewbe; 40.

<sup>lii</sup> Ihram- veshje për Haxh dhe Umre.

- 
- liii Xhizje- tatim që e paguajnë jomuslimanët në shtetin Islamik.
- liv Moshus- bimë aromatike nga e cila bëhen parfumet më të mira; misk.
- lv Një prej ndihmësve të tij, Enes bin Maliku thotë:  
Ai asnjëherë nuk më tha: “Përse e bëre këtë!?” kur gaboja diçka.
- lvi Nun, 4
- lvii Sexhde- vënia e ballit në tokë gjatë namazit
- lviii Muslimi - përmbledhësi më i njohur i haditheve pas Buhariut.
- lix ‘Alek: 1
- lx ‘Alek: 1-5
- lxi Hud: 44
- lxii Tewbe: 28
- lxiii Tewbe: 36
- lxiv Në këtë hutbe ishin prezentë rreth 140.000 besimtarë.
- lxv Maide: 3
- lxvi Ali Imran: 144